

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË 20 KOMUNA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Deçan, Dragash, Ferizaj, Glllogoc, Gjakovë
Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq
Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë
Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri**



Autore: Samire Sahiti

Hulumtuese: Artë Kastrati

Monitorues: Qëndrim Arifi, Diell Haxhimusa

Redaktor: Qëndrim Arifi, Albulena Nrecaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e INPO-s dhe IKD-së.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativa për Progres - INPO dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi - IKD në partneritet me Iniciativa për Progres - INPO.

Përkrahur nga:

Mars 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Metodologjia.....	7
I. GJETJET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME AKTIVITETET E INICUARA DERI TEK NËNSHKRIMI I KONTRATËS	9
1.1. Kriteria Diskriminuese në Dosjen e Tenderit	9
1.1.1. Kërkesa të paarsyshme të ndërlidhura me ISO Standarde	11
1.2. Shkurtimi i afateve për pranimin e tenderëve/ofertave	12
1.2.1. Zgjatja e afatit për vlerësimin e tenderëve/ofertave	15
1.3. Mos-saktësimi i datës së fillimit dhe përfundimit të aktiviteteve për punë.....	15
1.4. Mos-hartimi i Kushteve të Veçanta të Kontratës në Dosje të Tenderit	17
1.5. Shkelje tjera	18
II. PËRDORIMI I PROCEDURËS SË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË SI REZULTAT I PANDEMISË COVID - 19	19
2.1. Tenderët për Dezinfektim	20
2.2. Tenderët për Furnizim me material mbrojtës-shëndetësor	21
2.2.1. Shpenzimet për maska të thjeshta dhe maska/respirator FFP2	23
III. MENAXHIMI/ZBATIMI I KONTRATAVE	25
3.1. Plani për Menaxhimin e Kontratës	25
3.1.1. Plani i Menaxhimit të Kontratës i mangët	26
3.1.2. Emërimi i Menaxherit të Kontratës dhe përgatitja e PMK-së	27
3.1.3. Mos-dorëzimi i PMK-ve në Departamentin e Prokurimit	27
3.1.4. Mos-përmbushja e kontratës sipas afatit të planifikuar	28
3.2. Mos-saktësimi i fillimit dhe mbarimit të kontratës	28
3.3. Siguria e Ekzekutimit të kontratave	29
3.4. Shkelje të tjera	30
IV. PROKURIMI ME POENTIM.....	32
4.1. Dosja e Tenderit për tenderët me poentim.....	32
4.1.1. KVK-të dhe kriteret diskriminuese lidhur me ISO Standarde në Dosje të Tenderit	34
4.2. Peshimi i çmimeve për kontratat për servisim të automjeteve	35
4.3. Peshimi i çmimeve për kontratat për mirëmbajtje të rrugëve lokale	36
4.4. Kontratat - kategoria punë me kriterin për dhënie çmimi më i lirë më poentim.....	37
V. Rekomandime	38
Rreth INPO	39
Shtojcë. 81	40

Lista e Tabelave

Tabela 1. Shpenzimet për dezinfektim të hapësirave publike	21
Tabela 2. Shpenzimet e komunave për veshje komplet/COVERALL	22
Tabela 3. Shpenzimet për maska të thjeshta	23
Tabela 4. Shpenzimet për maska/respirator FFP2	24
Tabela 5. Çmimet e paguara për mirëmbajtje dhe servisim	35

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DNPDF	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve
FDT	Fleta e të Dhënave të Tenderit
PMK	Plani për Menaxhimin e Kontratës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurim Publik
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
OE	Operator Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
INPO	Iniciativa për Progres
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
KPK	Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
KVK	Kushtet e Veçanta të Kontratës
ZKA	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
ZPP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport të monitorimit INPO ka identifikuar një mori gjetjesh të cilat i karakterizojnë shumicën e komunave të monitoruara dhe gjetje të tjera të veçanta që janë karakteristikë e vetëm një komune. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti janë bërë nga monitorimi i 81 aktiviteteve të prokurimit, respektivisht, dyzet e një (41) aktivitete të prokurimit janë monitoruar nga faza e inicimit e deri te nënshkrimi i kontratës dhe dyzet (40) aktivitete të menaxhimit. Monitorimi përfshinë njëzet (20) komuna të Republikës së Kosovës. Secilës komunës mesatarisht i janë monitoruar dy (2) aktivitete të prokurimit nga faza e inicimit deri te nënshkrimi i kontratës dhe dy (2) aktivitete të menaxhimit të kontratave, përkatësisht nga faza e nënshkrimit deri në përfundim të implementimit të kontratës.

Në përgjithësi gjetjet tregojnë se integriteti i procesit të prokurimit publik në komunat e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë i cënueshëm. Diskriminimi apo trajtimi jo i barabartë i OE-ve si rezultat vendosjes së kriterëve diskriminuesë në dokumentet e tenderit, të cilat krijojnë pabarazi dhe kufizim të konkurrencës vazhdon të jetë problem kryesor në komuna.

Tutje ndër gjetje kryesore të këtij raporti janë:

- Aplikimi i kriterëve diskriminuesë në dosje të tenderit, siç janë kërkesat për ISO standarde të tepërta apo jo relevante me natyrën e prokurimit, kufizim i distancës territoriale në kontratat e servisimit të automjeteve, kërkesat për numër të madh të fuqisë punëtore, apo kërkesa të larta rreth kapaciteteve profesionale të OE-ve.
- Shkurtimi i afateve për pranimin e tenderëve në kundërshtim me ligjin.
- Mos-saktesimi i afatit tëpërmbylljes së kontratës, respektivisht fillimit dhe përfundimit të kontratës. Komunat vazhdojnë që afatet kontraktuale t'i paraqesin me ditë pune/ kalendarike apo muaj.
- Mos-hartimi i kushteve të veçanta të kontratës gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.
- Administrimi i dobët i implementimit të kontratave, ku përfshihet mos hartimi i planeve të menaxhimit të kontratave konform kërkesave ligjore, mos dorëzimi i tyre në zyret e prokurimit, hartimi i tyre para nënshkrimit të kontratës apo edhe para emërimit të menaxherit të kontratës.
- Skadimi i validitetit të sigurisë së ekzekutimit të kontratave para përmbylljes së kontratave dhe para afateve kohore të parapara me ligj.
- Përdorimi i kriterit për dhënie “çmimi më i lirë me poentim/peshim në tenderët për ekzekutimin e punëve, ku sasi dhe njësi të paramasave mund të identifikohen dhe planikohen.
- Kontraktimi i artikujve me çmime shumë të larta përmes procedurës së kufizuar pa publikim të njoftimit për kontratë gjatë pandemisë Covid - 19 dhe kufizim i konkurrencës, me vetëm një (1) OE të ftuar për ofertim.

Gjetjet e këtij raporti u janë komunikuar komunave për komentim. Pjesa dërmuese e komunave, janë pajtuar me gjetjet dhe janë zotuar se gjetjet dhe rekomandimet do të adresohen. Tutje INPO, rekomandon që komunat të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive në ngritjen e transparencës, mbi mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e të gjithë zyrtarëve të përfshirë në procedura të prokurimit publik, të cilët haptas veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, aplikimin e kriterëve kufizuese/diskriminuese dhe të tjera veprime që e cenojnë në çfarëdo forme integritetin e proceseve të prokurimit publik.

INPO, po ashtu rekomandon që administrimi i implementimit dhe menaxhimi i kontratave të jëtë më cilësor dhe më llogaridhënes. Menaxherët e kontratave të jenë më të përgjegjshëm dhe aktiv në kryerjen e detyrave dhe obligimeve për zbatim të suksesshëm të kontratave.

Metodologjia

Iniciativa për Progres (INPO) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) *(në vazhdim të raportit e gjeni si INPO)* me qëllim që të hartojnë një raport sa më real dhe analitik në lidhje me zbatimin konceptual dhe sipas obligimeve ligjore të cikleve të prokurimit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit dhe analizës.

Hulumtimi përfshinë monitorimin dhe analizimin e 81 aktiviteteve të prokurimit, respektivisht 41 aktivitete nga inicimi i prokurimit e deri tek lidhja e kontratës dhe 40 aktivitete të menaxhimit të kontratës, në këto komuna: Deçan, Dragash, Ferizaj, Gllogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviç, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Mesatarisht, secilës komunë i janë monitoruar nga katër (4) tenderë, dy (2) inicime dhe dy (2) menaxhime të kontratës. Ky monitorim është zhvilluar për periudhën mars 2019 deri në fillim të dhjetorit 2020. Monitorimi gjithashtu përfshinë edhe rastet e dhënies së kontratave më kriterin çmimi më i lirë me peshim/poentim dhe kontratat e nënshkruara me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, pra kontratat e nënshkruara në fillim të shfaqjes së pandemisë Covid-19.

Hulumtimi dhe analizimi i të gjitha dokumenteve dhe gjendjes faktike është bërë nga monitoruesit dhe hulumtuesit e INPO-së, në 20 komuna. Metoda e përzgjedhjes së tenderëve/kontratave për t'u analizuar dhe monitoruar është bazuar në indikatorë automatik siç janë: (i) aktiviteti i prokurimit me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, (ii) rastet e eliminimit të të gjitha ofertave që kanë aplikuar, përveç asaj fituese, (iv) tenderët me afate të shkurtuara, si dhe sipas rrezikut të sektorit *(shtrimit të rrugëve, tenderët e mirëmbajtjes, tenderët e servisimit, furnizimeve, etj)*.

INPO bazuar në obligimet ligjore dhe planet e prokurimit është bazuar në dy indikatorë kyç për vlerësimin e zbatimit të ligjit në procedurat dhe fazat e prokurimit gjatë zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit dhe menaxhimit të kontratës.

Indikator 1: Aktiviteti i prokurimit përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për

Prokurim Publik (*RrUOPP*). Ky indikator është matur duke analizuar dokumentet e secilit aktivitet, si në vijim:

1. Kërkesa për iniciimin e aktivitetit të prokurimit nga njësia kërkuuese;
2. Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (B04);
3. Njoftimi për kontratë (B05);
4. Dosja e tenderit (B17);
5. Paramasa dhe paralogaria;
6. Vendimi i formimit të Komisionit për hapje;
7. Procesverbali i hapjes së tenderit (B12);
8. Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësimin e tenderëve;
9. Raporti i vlerësimit të tenderëve (B36);
10. Njoftimi për dhënie të kontratës (B08);
11. Kontrata; si dhe
12. Vendimi për caktimin e menaxherit/es së projektit/kontratës.

Indikatori 2: Menaxhimi i kontratës përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas LPP dhe RrUOPP dhe legjislacionin sekondar, duke i monitoruar hapat si në vijim:

1. A përmban dosja e menaxhimit të kontratës dokumentet e kërkuara për procesin e menaxhimit të kontratës - regjistri i menaxhimit të kontratës. (sipas nenit 61.30 të RrUOPP)?;
2. A është caktuar Menaxheri i kontratës para fillimit të implementimit?;
3. A është përgatitur Plani i menaxhimit të kontratës dhe nëse po a është bërë më kohë dhe konform kërkesave të tij?;
4. A janë bërë pagesat sipas periudhave për pagesa të përcaktuara në kontratë?;
5. A ka pasur vonesa dhe a ka përfunduar kontrata?;
6. A janë zbatuar “ndëshkimet” për vonesat?;
7. A është kërkuar sigurimi i ekzekutimit të kontratës konform kërkesave ligjore?;
8. A është përcaktuar data e përfundimit të kontratës?


Të gjitha këto dokumente INPO i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike dhe platformës elektronike për prokurim publik. Pas sigurimit të dokumentacionit, INPO ka analizuar përmbajtjen e të gjitha dokumenteve të aktiviteteve të prokurimit, ka identifikuar gjetjet, ka bërë vlerësimet në lidhje shkeljet e evidentuara dhe më pas në disa raste ka zhvilluar intervista me zyrtarët e prokurimit si dhe akterët e tjerë me rëndësi për hulumtimin.

I. GJETJET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME AKTIVITETET E INICUARA DERI TEK NËNSHKRIMI I KONTRATËS

INPO ka monitoruar 41 aktivitete të prokurimit në 20 komuna duke filluar nga faza e inicimit të aktivitetit, publikimit të njoftimit për kontratë e deri të nënshkrimi i kontratës. Nga këto aktivitete të monitoruara shtatë (7) janë nga kategoria e furnizime, 18 shërbimeve, dhe 16 nga kategoria për punë. Prej 41 aktiviteteve të monitoruara, në 15 prej tyre kriteri i dhënies së kontratës është *çmimi më i lirë me peshim/poentim*.¹ Sa i përket vlerës së kontratës, nëntë (9) janë me vlerë të madhe, tridhjetë (30) me vlerë të mesme dhe tri (3) me vlerë të ulët.

Gjatë monitorimit dhe analizimit të dokumenteve të tenderëve, INPO ka gjetur se komunat në përgjithësi nuk rrespektojnë kërkesat e LPP-së dhe legjislacionit sekondar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit. Në komunat e monitoruara, INPO ka gjetur se shkurtimi i afatave kohore për pranimin e ofertave dhe vendosja e kriterëve diskriminues vazhdojnë të jenë problemet kryesore në prokurim, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në kufizimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të OE-ve.

Gjetjet kryesore të monitorimit të tenderëve nga faza e inicimit deri të lidhja e kontratës janë:



1.1. Kriterë Diskriminues në Dosjen e Tenderit

AK-të gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e OE-ve². Legjislacioni në fuqi kërkon që dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

¹ 15 aktivitete që lidhen me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë janë të monitoruara në kapitullin IV të këtij raporti.

² Shih, neni 7, lidhur me nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

- Kufizon konkurrencën në mesin të OE, ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

INPO ka gjetur se komunat kanë vendosur kritere diskriminuese të cilat mund të kufizojnë konkurrencën ndërmjet OE-ve. Këto gjetje tregojnë se në disa raste janë vendosur kërkesa të larta për numrin e punëtorëve, vlera e kërkuar për kontratat e realizuara në tri vitet e fundit e tejkalon vlerën e përcaktuar me dispozitat ligjore si dhe janë vendosur kërkesa të larta për ISO standarde.

Komuna e Ferizajt për aktivitetin “Vazhdimi i nënkalimit për këmbësor dalja në rrugën Emin Duraku - projekt dy-vjeçar” tek kapaciteti teknik-profesional ka kërkuar *“Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarisë (ose master) - konstruktiv ose infrastrukturë me 15 vite përvojë punë pas diplomimit, si dhe së paku 70 punëtor, ku së paku 10 prej tyre të jenë të certifikuar për sigurinë, shëndetin në punë dhe mbrojtje nga zjarri”*. INPO vlerëson se këto kritere janë shumë të larta dhe nuk janë nën frymën e LPP-së, përkatësisht nenit 28, paragrafi 2 të LPP-së sipas të cilit “AK do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE e interesuar. AK është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE”. Se kriteret kanë qenë të larta vërehet edhe nga fakti se vetëm dy (2) OE kanë ofertuar.³

Komuna e Gjakovës për aktivitetin “Ndërtimi i ashensorit në QKMF” ka kërkuar që ndër tjerash *“Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku dhjetë (10) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit dhe një inxhinier i diplomuar i makinerisë apo master - drejtimi Prodhimtari me pesë (5) vite përvojë pune pas Diplomimit, një inxhinier i diplomuar ndertimtarisë apo master - drejtimi Konstruktiv me pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit.”*⁴ Se kërkesat për këtë aktivitet kanë qenë të larta dhe jo në harmoni me legjislacionin në fuqi tregon edhe fakti se për këtë aktivitet janë vetëm dy (2) oferta, gjë që ka ndodhur si pasojë e kërkeave të larta, sepse mesatraja e ofertave për një tender në Kosovë është pesë (5).⁵

Komuna e Gjilanit për aktivitetin “Punë Publike- projekte të vogla në infrastrukturë” në dosjen e tenderit ka kërkuar që “menaxheri/udhëheqësi i punishtes të jetë inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë me minimum 10 vite përvojë punë.”⁶ Se këto kushte kanë qenë të larta e arsyeton edhe eliminimi i dy (2) OE-ve, të cilët nuk kanë arritur të i plotësojnë këto kushte/kritere të Dosjes së Tenderit.⁷

Përveç kriterëve të lartpërmendura, INPO ka vërejtur shkelje edhe në rastet kur AK-të tek kërkesat për mundësitë teknike dhe profesionale, në kundërshim me ligjin kanë kërkuar vlerën e kontratave të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit.

³ Shih Njotimin për Dhënie të Kontratës, 29.06.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Reports/2019/alb/Raporti%20vjetor%202019_KRPP_PDF.pdf

⁴ Shih Dosjen e Tenderit, 11.08.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1007179

⁵ Raporti vjetor i KRRP-së, 2019. I qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Reports/2019/alb/Raporti%20vjetor%202019_KRPP_PDF.pdf

⁶ Shih Dosjen e Tenderit 30.03.2020 e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=798729

⁷ Shih, Vendimin e AK-së se bashku me Letra Standarde, 13.05.2020. I qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=798729

Në rastin e Komunës së Gjakovës, INPO ka gjetur se për aktivitetin “Ndërtimi dhe sanimi i urave” ka vendosur kriter diskriminues në rastin e kërkesës që *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) në vlerë prej jo më pak se 140.000, 00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të minimum 60% të vlerës së kërkuar kontrata të natyrës së ngjashme.”*⁸ INPO vëren se vlera e parashikuar e kontratës ishte 49,991.40€ dhe në këtë kuptim vlera e kërkuar e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit është dashur të jetë më së shumti në vlerë prej 74,879.10€. Rrjedhimisht komuna ka kërkuar trefishin e vlerës së përbashkët të punëve të ngjashme të kryera në tri vitet e fundit. Këto veprime të komunës kufizojnë pjesëmarrjen e barabartë të OE-ve në tender.

1.1.1. Kërkesa të paarsyshme të ndërlidhura me ISO Standarde

INPO gjatë monitorimit ka vërejtur se komunat në disa raste kanë vendosur kërkesa të paarsyeshme të ndërlidhura me ISO standarde.

Komuna e Deçanit në aktivitetin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” në kushtet për pjesëmarrje ka kërkuar ISO - IEC 27001:2013 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë informacionit) - ky certifikim nuk është i nevojshëm pasi nuk lidhet direkt me ofrimin e shërbimit për të cilin është inicuar ky aktivitet i prokurimit i cili është për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në Komunën e Deçanit. Po ashtu, KRPP ka nxjerrë njoftim, më të cilin iu kërkon AK-ve të mos përdorin kritere të cilat nuk kanë lidhshmeri me projektin.⁹

Komuna e Gjilanit për aktivitetin “Rrënimi i Objekteve” ka kërkuar disa ISO standarde të cilat nuk janë konform kërkesave ligjore dhe njoftimit të KRPP-së, madje njëra nga to është e shfuqizuar. Kërkesat e komunës në këtë rast kanë qenë: OE duhet të jetë i pajisur me Certifikata ISO 9001: 2015, ISO 14001: 2015 dhe me Certifikatë OHSAS 18001: 2007, përveç këtyre komuna ka kërkuar nga OE që të ketë dhe një person për mbrojtje dhe siguri në punë, bazohet në sistemin e vendosur në kompani i cili është trajnuar dhe certifikuar me OHSAS 18001 dhe minimum dy (2) puntorë të certifikuar me ISO 9001:2008 për menaxhim të cilësisë me data valide. Kjo e fundit përditësohet çdo pesë (5) vite dhe i bie të jetë e shfuqizuar dhe zëvendësuar me ISO 9001:2015. Këto kërkesa potencialisht kanë rezultuar në interesim të vogël të OE-ve për të ofertuar dhe si rezultat numri i ofertuesve është vetëm dy (2).

INPO gjithashtu ka vërejtur se edhe Komuna e Vitisë në Dosjen e Tenderit “Projekti ta pastrojmë Kosovën”, ka kërkuar numër të lartë të ISO standardeve, respektivisht ka kërkuar 9001:2015, 14001:2015, 18001: 2007, 45001:2018, 9606-1,¹⁰ këto janë disa kritere të cilat nuk përputhen shumë me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE e interesuar. Kjo dëshmohet

⁸ Shih Dosjen e Tenderit, 23.06.2020 e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=928895

⁹ Shih linkun: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Notices/alb/398/001.jpg>

¹⁰ Shih Dosjen e Tenderit, 01.11.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=704458

me faktin se nga katër (4) OE, përveç OE fitues të gjithë janë shpallur të pa përgjegjshëm dhe kryesisht për shkak të mos plotësimit të ISO standardeve.¹¹

1.2. Shkurtimi i afateve për pranimin e tenderëve/ofertave

Aplikimi i afateve të përshpejtuara është i paraparë me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë, respektivisht nenin 46 të këtij ligji. Ligji mundëson shkurtimin e afateve vetëm kur ka arsye të qëndrueshme dhe të pashamngshme. Gjatë monitorimit INPO ka vërejtur se 10 komuna, në 11 tendre kanë shkurtuar afatet kohore për pranimin e tenderëve/ofertave në kundërshtim me ligjin.

Komuna e Deçanit për aktivitetin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit” ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave dhe arsyetimi i dhënë nga komuna është: *“Duke u bazuar në faktin se janë disa rrugë tejet të damtuara nga dimri i kaluar dhe nevojës së madhe për qarkullimin e qytetarëve dhe mallrave”*.¹² Ky arsyetim i dhënë nga komuna është i paqëndrueshëm dhe kjo vë në pah një planifikim jo të mirë të komunës, pasi komuna gjendjen e rrugëve është dashur ta ketë parasysh gjatë hartimit të Planit të Prokurimit, ku është dashur të planifikohet edhe afati kohor sa më i hershëm për fillimin e procedurave të prokurimit. Tutje, INPO ka gjetur se Komuna ka dy projekte të përfshira në Plan të prokurimit që kanë të bëjnë me mirëmbajtje të rrugëve, duke parashikuar që koha e fillimit të procedurave të prokurimit për këto projekte të jetë në pjesën e dytë të vitit, ku njëra madje është paraparë të fillojë në dhjetor e tjetra në shtator.

Komuna e Deçanit për aktivitetin “Furnizim me Material Laboratorik”¹³, ka shkurtuar afatin për dorëzimin e tenderëve/ofertave përtej minimumit të lejuar me dispozitat ligjore. Data e publikuar e Njoftimit për kontratë në e-prokurim është 02.03.2020, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e tenderëve/ofertave është 09.03.2020. Sipas dispozitave ligjore, afati kohor për dorëzim të tenderëve llogaritet me datën e publikuar të Njoftimit për Kontratë dhe mund të shkurtohet bazuar në rregullat e posaçme të përmendura më lart në minimum 10 ditë për kontratat me vlerë të mesme në rastin kur përdoret procedura e hapur. Ndërsa Komuna në këtë rast ka lënë mundësinë për aplikim vetëm tetë (8) ditë. Edhe pse arsyetimi i Komunës duket se është konform dispozitave ligjor në asnjë mënyrë ligji nuk lejon që të tejkalohen afatet minimale për ofertim.

Komuna e Shtimes për aktivitetin “Rregullimi i Hapësirave Rekreative Sportive tek Qendra Rinore”,¹⁴ kishte shkurtuar afatet me arsyetimin se *“me qenë se jemi ka fundi i vitit, mund të ketë probleme me kushte atmosferike”*. Ky aktivitet ka mundur të iniciohet më herët dhe të mos sjellë pasojë në shkurtim të afatit duke i cënuar OE-ve mundësinë për të shprehur interesim në ofertim të mundshëm. Ndërkaq, në aktivitetin e prokurimit “Transporti i pacientëve për Hemodializë -Ri-

¹¹ Shih Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, 20.11.2019, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=757088

¹² Shih Njoftimin për Kontratë, 20.05.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=870480

¹³ Shih Njoftimin për Kontratë, 02.03.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=796122

¹⁴ Shih Njoftimin për Kontratë, 06.09.2019, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=627824

Tenderim”¹⁵ komuna ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave sipas arsyetimit *“Pasi kontrata përfundon me 15.04.2020, dhe nuk ka transport për pacientat me hemodializ”*. Kjo arsye qëndron pasi edhe ishte ri-tenderim si dhe është e llojit të urgjencave. Megjithatë, komuna është dashur të bëjë një planifikim më të mirë, veçanërisht te llojet e këtyre aktiviteteve që janë të ndjeshme dhe rrezikojnë direkt mirëqenien e qytetarëve. Për më tepër, një shkurtim i tillë ka cenuar mundësinë për të shprehur interesimin e OE-ve të tjera për ofertim, dhe si rezultat i këtij shkurtimi ka ofertuar vetëm një (1) OE.¹⁶

Komuna e Glllogocit për aktivitetin *“Renovimi i Hapësirave dhe Inventarizimi i Qendrës Rinore”*,¹⁷ kishte shkurtuar afatet pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm duke u arsyetuar se *“Për shkak të kushteve teknike në terën si dhe terrenit të pershtatshëm për punë kërkohet që projekti të shpallet me afatë të shkurtuar”*. Ky arsyetim nuk përputhet me rastet kur ligji iu mundëson shkurtim të afatit për arsye se terreni është dicka që mund të parashikohet dhe të vlerësohet paraprakisht, pra para se të inicohet një aktivitet i tillë një vlerësim i gjendjes faktike është i domosdoshëm.

Komuna e Suharekës aktivitetin *“Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi- Lagjja Zekolli), Suharekë”*¹⁸ e ka inicuar me shkurtim të afateve, nga 40 ditë sa është minimumi për kontratë me vlerë të madhe për punë në 23 ditë dhe të njëjtën e ka evidentuar në njoftimin për kontratë me arsyetimin që *“për këtë projekt është nëshkruar një marrëveshje në mes të MIT dhe Komunës Suharekë, dhe është urgjente që ky projekte të fillojë të realizohet për shkak të sezonës dhe natyrës së punëve që duhet të kryhën në teren”*. Kjo arsye e dhënë nga komuna nuk është e qëndrueshme për të shkurtuar afatet kohore për arsye se komuna është dashur të ketë parasysh këtë gjatë hartimit të Planifikimit të Prokurimit dhe të parasheh fillimin e këtij projekti në periudhë më të përshtatshme.

Komuna e Mitrovicës së Jugut për aktivitetin *“Rregullimi i Nyjeve Sanitare (Gjimnaz)”*¹⁹, ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave dhe arsyetimi i dhënë nga komuna është se *“Mëqense shkollat janë në pushim kërkojmë të shkurtohet afati që të kryhën punet gjatë këtij pushimi”*. Arsyetimi nuk është i qëndrueshëm sepse afati i fundit për pranim të tenderëve është deri më 28.08.2019 dhe paraqet kohën kur pothuajse pushimi veror përfundon dhe mbeten vetëm pak ditë deri në fillimin e vitit të ri shkollor. Duke pasur parasysh kohën që marrin procedurat deri në nënshkrimin e kontratës është pothuajse e pamundur të fillojnë punimet para përfundimit të pushimit veror e aq më pak të mendohet se ato mund të përfundojnë brenda kësaj kohe.

¹⁵ Shih Njoftimin për Kontratë, 08.04.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=820992

¹⁶ Shih Njoftimin për Dhënie të Kontratës, 24.04.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=820992

¹⁷ Shih Njoftimin për Kontratë, 01.11.2019, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=751603

¹⁸ Shih Njoftimin për Kontratë, 29.08.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=617993

¹⁹ Shih Njoftimin për Kontratë, 19.08.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=604251

Po ashtu, Komuna e Mitrovicës së Jugut edhe për aktivitetin “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale”²⁰, kontratë me vlerë të madhe, në Njoftimin për Kontratë, ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave në 18 ditë nga 40 sa është edhe minimum i lejuar për këto kontrata. Komuna arsyetimin për këtë shkurtim të afatit e lidhë me pandeminë Covid-19 duke u arsyetuar se shumë automjete janë jashtë funksionit për shkak të pamundësisë për servisim, duke përfshirë autoambulancat e QKMF-së. Edhe pse në parim një arsyetim i tillë duket i drejtë, një veprim i tillë i komunës prapëseprapë nuk e arsyeton shkurtimin e afatit për pranim të tenderëve pasi në bazë të njoftimit të KRPP-së për përdorim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, AK-ve u ishte lejuar të zhvillojnë procedura duke mosrrezikuar pezulimin e aktiviteteve urgjente.²¹ Më konkretisht, kjo procedurë ka mundur të zhvillohet sipas Planit të Prokurimit.

Komuna e Ferizajt për aktivitetin “Vazhdimi i nënkalimit për këmbësor dalja në rrugën Emin Duraku - projekt dy-vjeçar”²² ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave dhe arsyetimi i komunës është se “*është kërkesë nga Hekurudhat e Kosovës që projekti të përfundoj sa më shpejtë*”. Pra, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me rrethana urgjente e as të jashtëzakonshme dhe kjo vërtetohet edhe me faktin se nga e-maili i datës 13.11.2020, Menaxheri i Projektit deklaron se ende nuk kanë filluar punët dhe janë duke e detajizuar projektin. Sikur të ishte me kaq urgjencë punët do të duhej të fillonin menjëherë. Shkurtimi i afateve cenon rëndë parimin barazia në trajtim dhe jo-diskriminim. Se është cenuar ky parim vërehet edhe nga fakti se për këtë aktivitet kanë qenë vetëm dy (2) oferta.²³

Komuna e Mitrovicës së Veriut për aktivitetin “Rindërtimi i infrastrukturës rrugore të pjesës së Rrugës Kralja Petra I në Mitrovicën Veriore”²⁴ ka shkurtuar afatin kohor për dorëzimin e tenderëve/ofertave, dhe në bazë të hulumtimit të INPO-së rezulton që Komuna lidhur me këtë aktivitet nuk ka pasur njoftim paraprak. Në bazë të LPP-së kur një aktivitet ka vlerë të madhe minimumi i afatit kohor duhet të jetë 40 ditë, ndërsa Komuna e Mitrovicës së Veriut këtë afat e ka zvogëluar në 15 ditë. Pra, shkurtimi i afatit është nën minimumin e lejuar pasi në rastet kur ka njoftim paraprak një aktivitet i vlerës së madhe më së shumti mund të shkurtohen në 24 ditë. Sipas Komunës, shkurtimi i afatit ka qenë për arsye se “shkurtimi i procedurës kryhet për shkak të kohëzgjatjes së periudhës së verës (ditë pa reshje), në mënyrë që të zbatohet projekti në kohë”. Nuk është arsye e qëndrueshme që të shkurtohen afatet për shkak të arsyeve që ka cekur Komuna e Mitrovicës së Veriut, sidomos duke pasur parasysh që këtë procedurë do të mund ta inicionte shumë më herët dhe jo të priste deri në muajin qershor, madje në bazë të paragrafit të lartpërmendur këto shkurtime nuk mund t’i atribuohen veprimeve apo mosveprimeve të AK-së. Shkurtimi i afateve ka pasoja të shumta për autoritetin kontraktues, kjo vërehet sidomos me

²⁰ Shih Njoftimin për Kontrate, 01.05.2020, i qasshëm në: [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841076)

[gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841076](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841076)

²¹ Shih Njoftimin e KRPP-se, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Notices/alb/412/412.pdf>

²² Shih Njoftimin për Kontratë, 22.05.2020, i qasshëm në: [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905)

[gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905)

²³ Shih Njoftimin për dhënie të Kontratës, 29.06.2020, i qasshëm në: [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905)

[gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=873905)

²⁴ Shih Njoftimin për Kontratë, 22.06.2020, i qasshëm në: [https://e-prokurimi.rks-](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=921814)

[gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=921814](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=921814)

faktin që për këtë tender ka ofertuar vetëm një (1) OE,²⁵ dhe po të ishte afati i rregullt ligjor, së paku 40 ditë, për këtë aktivitet do të mund të konkurronin më shumë OE dhe Komuna do të mund të nënshkruante kontratë me çmim më të lirë për shkak të konkurrencës që potencialisht mund të kishte në këtë rast.

1.2.1. Zgjatja e afatit për vlerësimin e tenderëve/ofertave

Përveç rasteve kur komunat i kanë shkurtuar afatet për dorëzim të tenderëve, INPO ka vërejtur se ka edhe raste kur komunat e kanë zgjatur procesin e vlerësimit të tenderëve përtej periudhës së paraparë me dispozitat ligjore të prokurimit publik. Sipas nenit 41.2 të RrUOPP *“Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.”*²⁶ Në vijim janë të parqitura rastet kur komunat kanë vepruar në kundërshtim me këtë nen.

Komuna e Gjakovës për aktivitetin “Ndërtimi i ashensorit në QKMF” ka zgjatur procedurën e vlerësimit të tenderëve përtej periudhës së paraparë me RrUOPP. Hapja e tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit është bërë më 02.09.2020 ndërsa procesi i vlerësimit është përfunduar më 05.10.2020,²⁷ do të thotë tri (3) ditë përtej afatit të lejuar me ligj. Kjo ka mundur të rezultojë në vonesa në implementimin e kontratës e rrjedhimisht në ndërtimin dhe vënien në funksion të ashensorit. Megjithatë, lidhur me këtë çështje komuna është sqaruar se kjo vonës ka qënë për shkak se anëtarët e komisionit vlerësues kanë qënë me Covid-19.

Po ashtu, Komuna e Mitrovicës së Jugut për aktivitetin “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale”²⁸ ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi gjatë vlerësimit të tenderëve duke e zgjatur këtë proces përtej periudhës së paraparë me ligji”. Hapja e tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit është bërë më 18.05.2020 ndërsa procesi i vlerësimit është përfunduar më 25.06.2020 që i bie se ky proces ka zgjatur 39 ditë, përkatësisht nëntë (9) ditë përtej afateve ligjore për vlerësim. Kjo rezulton në vonesa në implementimin e kontratës e rrjedhimisht në servisimin e automjeteve të komunës. Për më tepër, komuna ka dështuar të përmbushë edhe qëllimin e shkurtimit të afatit për dorëzimin e tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit.

1.3. Mos-saktësimi i datës së fillimit dhe përfundimit të aktiviteteve për punë

Komunat shpeshherë nuk e saktësojnë datën e fillimit dhe përfundimit të implementimit të kontratës, kërkesë kjo e cila është obligative sipas nenit 20

²⁵ Shih Njoftimin për Dhënie të Kontratës, 17.05.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=921814

²⁶ Shih, neni 41.2 i RrUOPP, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>

²⁷ Raporti i vlerësimit i marrë përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike më 10.11.2020

²⁸ Shih Njoftimin për Kontratë, 01.05.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841076

paragrafi 11 pika k. e RrUOPP-së, sipas të cilit “*kërkohet që autoritetet kontraktuese saktësisht të caktojnë datën e fillimit dhe mbarimit të implementimit të projektit-kontratës*”. Gjithashtu, sipas interpretimit të KRPP-së 30.03.2017 me numër të protokollit 133/2017, AK-të obligohen të saktësojnë datën e fillimit dhe mbarimit të implementimit të kontratës.

Komuna e Suharekës në aktivitetin “Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Ruga Bashkim Gashi, Lagjja Zekolli), Suharekë”, kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka shënuar 300 ditë pas nënshkrimit të kontratës.²⁹

Komuna e Glllogocit në aktivitetin “Renovimi dhe Invertarizimi i Qendrës Rinore”, kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka është shënuar 30 ditë.³⁰ Komuna e Pejës në aktivitetin “Ndërtimi i shkollës së Artit Faza Finale”, kohëzgjatjen e kontratës apo afatet kohore për përfundim i ka të shënuara 60 ditë.³¹

Komuna e Gjakovës në aktivitetin “Ndërtimi dhe sanimi i urave”, kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka shënuar 12 muaj.³² Po ashtu në rastin e kësaj komune edhe në aktivitetin “Nërtimi i ashensorit në QKMF”, kohëzgjatja e kontratës apo afati kohor për përfundim është shënuar 40 ditë.³³ Komuna e Gjilanit në aktivitetin “Punë Publike- projekte të vogla në infrastrukturë” kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka shënuar 36 muaj pas nënshkrimit të kontratës³⁴. Po ashtu, në rastin e kësaj komune edhe për aktivitetin “Rrenimi i Objekteve”, kohëzgjatja e kontratës apo afati kohor për përfundim është shënuar 36 muaj pas urdhëresës për fillimin e punimeve deri në pranimin teknik përfundimtar të punimeve.³⁵ Komuna e Mitrovicës së Jugut në aktivitetin “Rregullimi i nyjeve sanitare (Gjimnaz)”, në Njoftimin për Kontratë, kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka shënuar vetëm 30 ditë.³⁶

Komuna e Mitrovicës së Veriut për aktivitetin “Rindërtimi i infrastrukturës rrugore të pjesës së Rrugës Kralja Petra I në Mitrovicën Veriore”, në bazë të dokumentacionit që posedon INPO, datën e fillimit të punëve e ka paraparë me 15.07.2020. Sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës, vetëm saktësohet që punimet do të zgjasin 90 ditë, dhe nuk është saktësuar nëse periudha 90 ditore nënkupton 90 ditë pune apo 90 kalendarike. Komuna e Podujevës në aktivitetin “Ndërtimi i disa tereneve sportive” në Njoftimin për Kontratë kohëzgjatjen e kontratës apo afatin kohor për përfundim e ka shënuar 16 muaj.³⁷

²⁹ Shih Dosjen e Tenderit pjesa e Fletës së të Dhënave, 28.08.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=617993

³⁰ Shih Dosjen e Tenderit, 31.10.2019, e qasshme https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=751603

³¹ Shih Dosjen e Tenderit, 01.06.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=890233

³² Shih Dosjen e Tenderit, 28.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=820614

³³ Shih Dosjen e Tenderit, 11.08.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1007179

³⁴ Shih Dosjen e Tenderit të korigjuar, 30.03.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=798729

³⁵ Shih Dosjen e Tenderit, 26.08.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=615106

³⁶ Shih Njoftimin për Kontratë, 27.08.2019, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=615106

³⁷ Shih Njoftimin për Kontratë, 22.06.2020, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=921814

Në të gjitha rastet e përmendura më lart komunat kanë vepruar në kundërshtim me nenin 20.11 pika k të RrUOPP-së, ku sipas nenit 28 të LPP-së, Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të tregojë ku është e aplikueshme: data e fillimit dhe data e përfundimit të punimeve.³⁸

Mosdefinimi i një date të saktë të përfundimit të projektit, duke e lënë afatin e përfundimit të kontratës në ditë apo muaj e shpeshherë pa e përcaktuar fare nëse janë ditë pune apo kalendarike (për shembull 30 ditë punë nënkupton që projekti do të përfundojë pas pothuajse dy (2) muajve kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek qytetarët për arsye se pritshmëritë e tyre janë që të kenë informata të sakta dhe kualitative rreth shërbimeve që ata pritët të marrin.

1.4. Mos-hartimi i Kushteve të Veçanta të Kontratës në Dosje të Tenderit

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, Kushtet e Veçanta të Kontratës plotësojnë, shtojnë apo ndryshojnë dispozitat e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK). Kurdo që ka konflikt në mes të këtyre kushteve mbizotërojnë Kushtet e Veçanta.

Andaj, INPO ka monitoruar KVK-të, si pjesë obligative dhe shumë e rëndësishme e kontratës dhe ka gjetur se edhe pse Komunat/AK-të janë të obliguara ligjërisht t'i plotësojnë KVK-të në dosje të tenderit ato shpeshherë po veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe legjislacionin sekondar/dytësor për prokurim publik duke mos i plotësuar ato. Sipas nenit 18.3 të RrUOPP *“Kushtet e Veçanta duhet të plotësohet nga ZPP në kohën e përgatitjes së Dosjes së Tenderit”*.

Rastet në të cilat komunat nuk kanë plotësuar KVK-të gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit janë: Komuna e Deçanit në aktivitetin: “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit”;³⁹ Komuna e Mitrovicës së Jugut në aktivitetin “Rregullimi i nyjeve sanitare (Gjimnaz)”;⁴⁰ Komuna e Suharekës në aktivitetin “Shërbimet e sigurimit të automjeteve zyrtare”⁴¹ dhe Komuna e Leposaviçit në aktivitetin “Prokurimi i celularëve”⁴² dhe në aktivitetin “Prokurimi i pajisjeve për shuarjen e zjarrit”.⁴³ Mos-plotësimi i këtyre kushteve sjellë pasoja deri te mos pajtimet e mundshme në mes OE-ve dhe Komunave pasi OE në kohën e ofertimit nuk i ka të gjitha informatat e nevojshme dhe pastaj mund të mos pajtohet me kushtet e paraqitura më vonë në kontratë nga Komuna.

³⁸ Për më shumë shih neni 28 të LPP-së, lidhur me nenin 20.1 të RrUOPP-it, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret//shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

³⁹³⁹ Shih Dosjen e Tenderit, 22.05.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=870480

⁴⁰ Shih Dosjen e Tenderit, 16.08.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=604251

⁴¹ Shih Dosjen e Tenderit të 14.02.2020 e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=788403

⁴² Shih Dosjen e Tenderit, 03.09.2020, e qasshme në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1104902

⁴³ Shih Dosjen e Tenderit, 14.09.2020, e qasshme në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1120753

1.5. Shkelje tjera

Gjatë monitorimit, INPO ka vërejtur edhe disa shkelje të natyrave tjera si në rastet kur janë prezantuar çmime me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, rastet kur kërkesat/kushtet që janë të vendosura në Dosjen e Tenderit dallojnë me kushtet e vendosura në Njoftimin për Kontratë, si dhe kemi raste kur proceverbali i hapjes nuk është nënshkruar nga ana e ZPP.

Komuna e Kaçanikut për aktivitetin “Furnizimi dhe montimi i serrave për fermër”, në procedurë të prokurimit ka pranuar çmime me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore. Një gjë e tillë lejohet vetëm nëse në Dosjen e Tenderit AK e përdorur letrën jo-standarde të miratuara nga KRPP-ja. Pas analizimit të kontratës, përkatësisht listës së çmimeve INPO vëren se OE për dy (2) pozicione kishte ofruar çmime me tre (3), përkatësisht katër (4) numra pas pikës dhjetore. Për pozicionin “Gypa O25x1.5mm” kishte ofruar çmim 4.077€ për copë, ndërsa për pozicionin “Klipa ½” kishte ofruar çmim me 0.1265€ për copë. Kjo është rreptësisht e ndaluar sepse nuk është cekur nga Komuna e Kaçanikut në Dosje të Tenderit se do të pranohen çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Ofertën e OE fituese Komuna e Kaçanikut është dashur ta refuzojë si të pa përgjegjshme sepse është kërkesë ligjore, respektivisht neni 18.3 i RrUOPP sipas të cilit “Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore”⁴⁴. Nëse OE ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në këtë aktivitet komuna ka pranuar çmime me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhejtore dhe një gjë e tillë nuk e ka deklaruar në Dosje të Tenderit⁴⁵. Pra, nga kjo përfundojmë se të dy ofertat kanë qenë të papërgjegjshme dhe është dashur të anulohet aktiviteti në tërësi.

Shkelje tjera janë evidentuar në dy (2) aktivitetet e monitoruara në Komunën e Leposaviqit, “Prokurimi i celulareve” dhe “Prokurimi i pajisjeve për shuarjen e zjarrit”, ku INPO ka gjetur se të dhënat në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit nuk janë identike.⁴⁶ Respektivisht, në Njoftimin për Kontratë figurojnë kërkesat për dëshmitë e kërkuara sipas kërkesave të Nenit 65 ndërkaq në Dosjen e Tenderit këto kërkesa nuk figurojnë.

Dallime në përmbajtjen e informacioneve të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit janë vërejtur edhe në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale” komuna periudhën e vlefshmërisë së tenderit nuk e ka pasur identike në njoftimet e publikuara. Në Njoftimin për Kontratë kjo periudhë është paraparë të jetë 60 ditë ose dy (2) muaj ndërkaq në Dosjen e Tenderit është kërkuar 90 ditë apo 3 muaj. E njëjta gjë vërehet edhe tek periudha e vlefshmërisë së tenderit

⁴⁴ Shih neni 18.3 i RrUOPP-it, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret//shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

⁴⁵ Shih Dosjen e Tenderit, 30.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=834892

⁴⁶ Shih Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë për “Prokurimi i celulareve”, i qasshëm: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1104902 dhe për Prokurimin e pasijeve për shuarjen e zjarrit 15.09.2020, i qasshëm: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1120753

ku në Dosjen e Tenderit është 60 ditë ndërsa në Njoftimin për Kontratë është 90 ditë.

Mungesa e informacionit identik në njoftimet e publikuara krijon paqartësi për OE-të për shkak se OE-të *a priori* mund të bazohen në Dosjen e Tenderit dhe me këtë rast të mos paraqesin dëshmi për një kërkesë të tillë. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë në eliminim të padrejtë të operatorit ekonomik.

Shkelje tjetër që INPO ka evidentuar është se në dy (2) raste procesverbali i hapjes nuk është nënshkruar nga ana e ZPP. Mos nënshkrimi i procesverbalit të hapjes nënkupton shkelje të nenit 58.3 LPP dhe nenit 37.4 të RrUOPP ku saktësohet se procesverbali duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të hapjes, nga zyrtari i prokurimit dhe nëse është e aplikueshme, nga secili përfaqësues i tenderuesit që është i pranishëm në Seancën e Hapjes Publike. Raste të tilla vërehen tek Komuna e Gjakovës në aktivitetin “Ndërtimi dhe sanimi i urave”, dhe Komuna e Podujevës në aktivitetin “Ndërtimi i disa tereneve sportive”. Mos nënshkrimi i dokumenteve të tilla krijon mungës besimi tek OE-të, pasi nuk ka dëshmi se procesi i hapjes së tendereve ka shkuar në rregull.

II. PËRDORIMI I PROCEDURËS SË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË SI REZULTAT I PANDEMISË COVID - 19

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, është procedurë që i mundëson AK-së që pa publikim të njoftimit për kontratë, të negociojë termat e kontratës drejtpërdrejt me një apo më shumë OE. Kjo është një shmangie prej parimeve themelore të çiltërsisë, transparencës, dhe konkurrencës si dhe është procedurë shumë e jashtëzakonshme. AK përjashtimisht mund ta përdorë procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për dhënien e çdo lloji të kontratës, nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure. Çdoherë, kur përdoret kjo procedurë duhet të vepohet sipas nenit 6 të LPP-së, ku duhet që AK-të, të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Në secilin rast që komunat përdorin këtë procedurë duhet të njoftojnë KRPP-në brenda dy (2) ditëve nga data e marrjes së vendimit duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja.

Si rezultat i situatës së krijuar nga Covid-19, KRPP kishte lëshuar një njoftim ku iu mundëson të gjitha AK-ve të prekura nga vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, i datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës në shëndetin publik, t’i përdorin procedurat e negociuara që parashihen me nenin 35 të LPP-së.⁴⁷ Megjithatë, AK duhet të sigurohet se ekzistojnë rrethana precize që i arsyetojnë negociatat para se të vendoset për përdorimin e kësaj procedure.

Për të parë nga afër se si kanë vepruar komunat në këtë periudhë, pra në rrethana të jashtëzakonshme ku edhe lejohet përdorimi i kësaj procedure, INPO ka monitoruar 20 komuna që kanë zhvilluar këtë procedurë e që kryesisht janë për

⁴⁷ Shih njoftimin e KRPP-së, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=412>.

dezinfektim të hapësirave/objekteve publike dhe furnizim me pajisje mbrojtëse/mjekësore kundër Covid-19.

2.1. Tenderët për Dezinfektim

Komunat gjatë muajve mars-maj 2020, me qëllim të parandalimit të pandemisë Covid - 19, kanë zhvilluar tenderë për dezinfektim të hapësirave dhe objekteve publike me procedurë të negociuar pa publikim të Njoftimin për Kontratë. INPO ka paraqitur në tabelën numër një (1), të gjeturat nga komunat e monitoruara dhe nga të dhënat e paraqitura mund të vërehet se komunat gjatë kësaj periudhe kanë paguar çmime të ndryshme për shërbime të njëjta. Nga monitorimi vërehet se dezinfektimi më së liri i ka kushtuar Komunës së Dragashit e cila për 1 m² ka paguar 0.09 euro.⁴⁸ Ndërsa, shumica e komunave të tjera të cilat INPO i ka monitoruar kanë paguar çmime të ndryshme varësisht nga hapësirat e dezinfektuara, ku për dezinfektim të hapësirave të brendshme komunat kanë paguar më shumë ndërsa për dezinfektim të hapësirave të jashtme ato kanë paguar më pak. Rrjedhimisht, komuna që ka paguar më së shumti për dezinfektim të brendshëm janë: Komuna e Shtimes⁴⁹ me 0.32 euro për m², pasuar nga Komuna e Vitisë me 0.29 euro për m². Po ashtu, për hapësira të jashtme më së shumti kanë paguar Komuna e Shtimes dhe e Vitisë me nga 0.27 euro për m².

Për më tepër kemi komuna si ajo e Ferizajt që ka nënshkruar kontratë për dezinfektim pa çmim total të kontratës, përkatësisht në kontratë shkruan se “Vlera e parashikuar e kontratës është për këtë pasi sipas vendimit të Kuvendit Komunal për ndarjen e mjeteve financiare për sëmundjen globale Koronavirus është 50,000.00 euro, ndërsa çmimi i kontraktuar i shërbimeve për njësi për metër katror është 0.47 euro”.⁵⁰ Pra komuna nuk ka përdorur as kontratë kornizë e as peshim të çmimeve (poentim) mirëpo çmimin për dy (2) pozicione, përkatësisht dezinfektimi i objekteve publike 0.25 euro për m², dhe dezinfektimi i hapësirave publike 0.22 euro për m², e ka mbledhur dhe ka nxjerrë “çmimin për njësi” 0.47 euro për m². Tutje, INPO ka gjetur se faturat e OE-së, të paguara nga komuna janë në kundërshtim me kontratën dhe paramasën.

Ashtu, siç u theksua edhe më lartë për këtë kontratë kanë ekzistuar dy pozicione dhe njësia matëse për to është “m²”. Në faturën nr. 090 të datës 21.05.2020 OE kishte futur edhe “Vetura të policisë +ATK” të cilat i kishte numëruar me copë (gjithsej 35) ndërsa çmimin e kishte faturuar për copë e jo për m². Dezinfektimi i një veture Komunës së Ferizajt i ka kushtuar tri (3) euro dhe për këtë në total ka paguar 105 euro. Pra, nga kjo mund të përfundojmë se Komuna e Ferizajt ka paguar për pozicione që nuk janë paraparë me kontratë.

⁴⁸ Shih Kontratën, 19.05.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=865068

⁴⁹ Shih Kontratën, 27.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=837973

⁵⁰ Shih Kontratën, 08.05.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=855475

Tabela 1. Shpenzimet për dezinfektim të hapësirave publike

Dezinfektimi i hapësirave publike				
Nr.	Komuna	Sasia/Njësia (m ²)	Çmimi për njësi (€)	
1.	Gjakovë	200,000.00	Hapësira të brendshme	0.23
		240,000.00	Hapësira të jashtme	0.22
2.	Ferizaj	Nuk është deklaruar	Objektet publike	0.25
			Hapësira publike	0.22
3.	Prishtinë	78,000.00	0.20	
4.	Prizren	200,000.00	0.20	
5.	Podujevë ⁵¹	29,050.00	Hapësira të brendshme	0.24
		41,140.00	Hapësira të jashtme	0.19
7.	Dragash	100,000.00	0.09	
8.	Shtime	38,670.00	Hapësira të brendshme	0.32
		26,800.00	Hapësira të jashtme	0.27
9.	Kamenicë	17,800.00	0.28	
10.	Kaçanik	14,520.00	0.20	
11.	Viti	62,229.00	Hapësira të brendshme	0.29
		75,785.00	Hapësira të jashtme	0.27

Burimi: e-prokurimi⁵²

2.2. Tenderët për Furnizim me material mbrojtës-shëndetësor

Një lloj tjetër i tenderëve që është zhvilluar si masë parandaluese ndaj Covid-19, është edhe ai për furnizim me pajisje mbrojtëse shëndetësore. INPO ka monitoruar tenderë të ngjashëm në komunat e fokusit dhe ka krahasuar çmimet e kontraktuara për këto furnizime.

⁵¹ Sipas kontratës: sipërfaqet e brendshme do të dezinfektohen deri në tetë (8) herë, ndërsa të jashtme deri në katër (4) herë.

⁵² Shih Kontratat e vendosura në fund të raportit (Shtojcë)

Tabela 2. Shpenzimet e komunave për veshje komplet/COVERALL

Veshje komplet "Coverall"				
Nr.	Komuna	Sasia/ Njësia (copë)	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
1.	Prizren	1,000.00	25.00	25,000.00
2.	Dragash	1,050.00	10.00	5,300.00
3.	Ferizaj	1.00	12.50	Nuk është deklaruar
4.	Klinë	300.00	16.65	4,995.00
5.	Prishtinë	350.00	12.60	4,410.00
		320.00	12.20	3,904.00
		400.00	11.00	4,400.00
6.	Kaçanik	257.00	17.10	4,394.70

Burimi: e-prokurimi, kontrata e nënshkruara

Nga tabela numer 2, shohim se komunat kanë paguar çmime të ndryshme për produktin e njëjtë, ngjashëm sikurse në rastin e dezinfektimit të hapësirave publike. Komuna e Prishtinës për veshje komplet "Coverall" ka paguar deri në 12.60 euro për copë⁵³ ndërsa Komuna e Prizrenit për produktin e njëjtë ka paguar 25.00 euro për copë.⁵⁴ INPO më 28.07.2020 ka kontaktuar një kompani e cila bën distribuimin e materialeve shëndetësore dhe sipas tyre çmimi me shumicë për copë për një veshje "Coverall" është 2.53 euro, dhe në asnjë mënyrë nuk ka qenë 25.00 euro për copë (ka pasur lëvizje të çimeve në treg por jo deri në këtë masë deklarojnë nga kompania). Megjithatë, nga tabela lart shihet se komunat kanë paguar çmime shumë më të larta edhe pse kanë porositur me shumicë.

Gjithashtu, Komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontratë pa çmim total të kontratës, përkatësisht në kontratë shkruan se "Vlera e parashikuar e kontratës sipas vendimit të Kuvendit Komunal të datës 03.04.2020 numër 38 për ndarjen e mjeteve financiare për rastin e sëmundjes globale të Koronavirusit 50,000.00 euro, ndërsa çmimi i kontraktuar i furnizimeve është për njësi, duhet të jetë 154.44 euro".⁵⁵ INPO ka gjetur se në Dosjen e Tenderit, respektivisht tek specifikimet e detyrueshme teknike, komuna nuk ka përcaktuar sasi të planifikuara për furnizim, por ka vendosur vetëm numrin "1" duke u nënkuptuar që komuna nuk i di sasi të. Në dokumentet e tenderit nuk figuron se për këtë kontratë është përdorur kriteri për dhënie "çmimi më i lirë me peshim/poentim", i cili do të arsyetonte mungesën e sasive të artikujve që do të prokurohen.

INPO ka gjetur se kjo kontratë është inicuar në bazë të kërkesës së Drejtoreshës e QKMF-së në Ferizaj, e cila ka kërkuar nga Drejtoria e Shëndetësisë, që për nevoja

⁵³ Shih Kontratën, 23.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=835099

⁵⁴ Shih Kontratën, 06.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=820562

⁵⁵ Shih Kontratën, 08.05.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=926803

të QKMF-së të bëhet furnizimi me pajisje mbrojtëse.⁵⁶ Kërkesa e dorëzuar nga QKMF-ja përmbanë në mënyrë të detajuar 13 artikuj të ndryshëm së bashku me sasitë, njësitë dhe çmimet për njësi.

Ndërkaq, pas inicimit formal të aktivitetit të prokurimit⁵⁷ dhe gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit vërehet se komuna nuk ka vendosur sasi të njësitë në dokumentet e tenderit, siç i ka hartuar QKMF-ja.⁵⁸ Tutje, INPO ka gjetur se kjo kontratë është përmblyllur më anë të vetëm një (1) fletë-porositë, ku sasi të artikujve të kërkuar për furnizim janë identike me kërkesën e QKMF-së të bërë më 23.04.2020⁵⁹. OE ka lëshuar vetëm një faturë në vlerë prej 49,850.00€. Madje, INPO ka gjetur se komuna nuk ka luajtur rol proaktiv në ruajtjen e vlerës për paratë dhe përcaktimin e vlerës së kontratës, pasi vërejmë se çmimet e ofertuara nga OE fitues janë identike me çmimet e paraqitura për njësi nga ana e QKMF-së gjatë kërkesës për përgatitjen e tenderit për furnizim.

2.2.1. Shpenzimet për maska të thjeshta dhe maska/respirator FFP2

Komunat gjatë muajve mars-maj ishin furnizuar edhe me maska të cilat hyjnë në kuadër të tenderëve për furnizim me pajisje mbrojtëse mjekësore/shëndetësore. Nga tenderët e monitoruar vërehet se komunat çmimin e paguar për produktin e njëjtë e kishin më të përafërt për dallim nga shërbimet e dezinfektimit dhe veshjet e ashtuquajtuara “coverall”. Mesatarja e shpenzimeve për një maskë të thjeshtë është rreth 0.80 euro.

Tabela 3. Shpenzimet për maska të thjeshta

Maska të thjeshta				
Nr.	Komuna	Sasia/Njësia (copë)	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
1.	Gjilan	10.000,00	0,79	7.900,00
2.	Prizren	20.000,00	0,81	16.200,00
3.	Dragash	5.000,00	0,70	3.500,00
4.	Viti	3.000,00	0,80	2.400,00
5.	Kaçanik	2.500,00	0,80	2.000,00

Burimi: e-prokurimi, lista e çmimeve të OE fituese/kontrata. Kontratat e vendosura në shtojcë.

Siç mund të shihet nga tabela lartë komuna e cila ka paguar më së liri për maska të thjeshta është Komuna e Dragashit e cila ka pagur 0.70 euro për një maskë të thjeshtë. Ndërsa, Komuna e cila ka paguar më së shtrenjti është Komuna e Prizrenit

⁵⁶ Kërkesa Nr.291, 23.04.2020, e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

⁵⁷ Kërkesë për inicimin e procedurës së prokurimit, e datës 23.04.2020, nga njësia e kërkesës/drejtoria e shërbimeve publike dhe emërgjencave.

⁵⁸ Shih Dosjen e Tenderit dhe Listën e Përshkrimit të Çmimeve, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=926803

⁵⁹ Fatura nr. 237 -20, 15.05.2020, e siguruar përmes Kërkesës për Qasjes në Dokumente Publike, Komuna e Ferizajt

me 0.81 euro për një maskë të thjeshtë. Komuna e Kaçanikut dhe Komuna e Vitisë kanë paguar nga 0.80 euro për një maskë.

Ndërsa, për maskën/respiratorin FFP2 apo KN95, komunat kanë paguar mesatarisht 8.50 euro për copë, ku Komuna e Mitrovicës së Jugut ka paguar çmimin më të lartë prej 10 euro për një maskë FFP2 ndërsa, Komunën e Dragashit ka paguar për produktin e njëjtë 3.80 euro për copë.

Tabela 4. Shpenzimet për maska/respirator FFP2

Maska - FFP2				
Nr.	Komuna	Sasia/ Njësia (copë)	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
1.	Mitrovicë	700	10.00	7.000,00
2.	Prishtinë	1500	8.50	12.750,00
		1100	8.50	9.350,00
3.	Dragash	4500	3.80	17.100,00
4.	Ferizaj	1	8.50	nuk është deklaruar

Burimi: e-prokurimi, lista e çmimeve të OE fituese/kontrata. Kontratat e vendosura në shtojcë.

III. MENAXHIMI/ZBATIMI I KONTRATAVE

INPO ka monitoruar 40 kontrata duke analizuar aspektin e menaxhimit/zbatimit të tyre në 20 komunat e fokusit. Nga kontratat e monitoruara, 13 janë për kategorinë furnizime, 14 për kategorinë shërbime⁶⁰ dhe 13 për kategorinë punë. Nga gjithsej 40 kontratat e monitoruara, 17 janë të zhvilluara me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë⁶¹ dhe 23 me procedurën e hapur. Gjetjet kryesore nga monitorimi i kontratave në 20 komuna kanë të bëjnë kryesisht me katër (4) pikat e paraqitura si në vijim:

Plani për Menaxhimin e Kontratës (PMK)	
Mos-saktësimin e datës së fillimit dhe përfundimit të kontratës	
Sigurinë ekzekutimit të kontratës	
Shkelje të tjera	

3.1. Plani për Menaxhimin e Kontratës

Bazuar në LPP dhe në legjislacionin sekondar për prokurim, PMK duhet të jetë i rënë dakord në mes palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës dhe do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Projektit dhe OE. Menaxheri i Projektit duhet brenda dy (2) ditëve të punës, t’ia përcjell një kopje të planit për menaxhimin e kontratës departamentit të prokurimit.⁶²

PMK duhet të paktën të përfshijë: (i) emrin e zyrtarit/zyrtarëve të autoritetit kontraktues përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe ku është e aplikueshme rezidentin e kualifikuar për mbikëqyrje apo inxhinierin/inxhinierët e projektit; (ii) numrin dhe kategoritë e personelit ndihmës në dispozicion të zyrtarit për qëllime të menaxhimit të kontratave, duke përfshirë ekspertë teknik të jashtëm të rekrutuar; (iii) një afat kohor ose një plan projekt gantogram (ganat charts), diagrame për aktivitetet e menaxhimit të kontratave që përfshijnë kohëzgjatjen e kontratës. KRPP-ja e monitoron menaxhimin e kontratës.

Kontrata mund të menaxhohet nga një organ apo person jashtë AK-së, me kusht që Njësia Kërkuese mbikëqyrë menaxherin e jashtëm të projektit. Emërimi i organit

⁶⁰ 7 kontrata janë të monitoruara te pjesa e monitorimeve për COVID-19.

⁶¹ Tenderët e monitoruar me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, Covid-19, janë pjesë e kapitullit II të këtij raporti.

⁶² Neni 81, paragrafi 2 dhe 3 i LPP-së, lidhur me nenin 61.8 të RrUOPP-it, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret//shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20Operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>.

apo personit të jashtëm do të bëhet duke përdorur procedurat e përshtatshme të prokurimit për shërbime.

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit sipas RrOUPP-së:

- a. Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë; dhe
- b. Sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë.

Funksionet e Menaxherit të Projektit janë sipas RrOUPP-së:

- a. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

Nga kontratat e monitoruara, INPO ka vërejtur se PMK-ja është ende sfidë e madhe për komunat, pasi në shumicën e rasteve vërehen shkelje ligjore, të cilat rrjedhin si rezultat i mos përmbushjes së përgjegjësiave apo funksioneve të menaxherit të projektit dhe AK-së. Ndër gjetjet kryesore të monitorimit të fazës së menaxhimit të kontratës janë: (i) Plani i Menaxhimit të Kontratës është i mangët, (ii) menaxheri i kontratës i emëruar para nënshkrimit të kontratës, (iii) përgatitja e PMK-së para emërimit të menaxherit, (iv) mos-përmbushje e kontratës sipas afatit, si dhe mosdorëzimi i planeve të menaxhimit të kontratave tek departamenti i prokurimit, në vijim do të paraqiten shkeljet kryesore të evidentuara.

3.1.1. Plani i Menaxhimit të Kontratës i mangët

PMK-ja është dokument i krijuar bazuar në mbikqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale dhe ky plan duhet të freskohet/plotësohet bazuar në zhvillim të punëve. Si i tillë ky plan duhet të plotësohet në të gjitha fushat e kërkuara për një zbatim të drejtë të kontratës.

Megjithatë, INPO ka vërejtur se ka raste kur komunat nuk e plotësojnë në formën e duhur një plan të tillë.

Në rastin e Komunës së Deçanit për kontratat “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes-Penda Vranoc”⁶³ dhe “Furnizim me E - Kiosk”⁶⁴; dhe Mitrovçës së Jugut për kontratën “Furnizimi dhe montimi i Serrave të tipit Tunell 50 m² komplet me montim (10X5)-50 copë”⁶⁵, komunat kanë përgatitur Planet për Menaxhimin e Kontratave të cilat janë të mangëta dhe nuk përmbajnë disa prej të dhënave dhe detajeve të nevojshme, si për shembull nuk specifikohen datat për dorëzimet (për shërbimet, furnizimet apo punët), dhe si rezultat kjo mund të sjellë pasoja në vonesa të zbatimit të kontratave si dhe shkelje të parimit të transparencës duke mos ofruar informata se kur do të ndodhin dorëzimet e nevojshme.

Komuna e Mitrovçës së Jugut për kontratën “Furnizimi dhe montimi i Serrave të tipit Tunell 50 m² komplet me montim (10X5)-50 copë”⁶⁶ po ashtu, nuk ka përfshirë asnjë të dhënë për vlerën dhe kohëzgjatjen e sigurisë së ekzekutimit, edhe pse është pjesë e kërkesave të parashtruara nga komuna gjatë procesit të tenderimit.

3.1.2. Emërimi i Menaxherit të Kontratës dhe përgatitja e PMK-së

Sipas nenit 61.4 të RrUOPP “pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, ZPP do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ “ZKA” dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar ZPP”. INPO ka gjetur se Komuna e Gjakovës për kontratën “Furnizim me PC, Laptop, TV smart dhe projektor” fillimisht ka emëruar menaxherin e kontratës më 27.11.2019 e më pas ka nënshkruar kontratën më 04.12.2019.⁶⁷

Komunat po ashtu duhet që fillimisht të emërojnë menaxherin e kontratës dhe më pas të përgatitet PMK-ja nga ana e menaxherit. Komuna e Deçanit për kontratën “Furnizim me E-Kioskë” ka vepruar në kundërshtim me RrUOPP duke përgatitur PMK para emërimit të menaxherit të kontratës. Më konkretisht, PMK është përgatitur më 30.07.2019 ndërsa menaxheri i kontratës është emëruar më 31.07.2019.⁶⁸

3.1.3. Mos-dorëzimi i PMK-ve në Departamentin e Prokurimit

Gjatë monitorimit INPO ka gjetur se në disa raste PMK-të nuk u janë dërguar departamentit të prokurimit nga ana e menaxherëve të kontratave dhe me këtë rast nuk është vepruar konform dispozitave ligjore. Menaxheri i kontratës nuk i ka përcjellur PMK-në departamentit të prokurimit në Komunën e Pejës për kontratën

⁶³ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁶⁴ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁶⁵ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁶⁶ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁶⁷ Vendimi për emërimin e Menaxherit të projektit i siguruar përmes kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, si dhe kontrata, 09.12.2019 e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=629457

⁶⁸ Vendimi për emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe PMK-ja të siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike.

“Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën Bill Clinton në Pejë”⁶⁹. Ndërsa, në Komunën e Ferizajt për kontratat “Furnizimi i QKMF-së dhe Spitalit të Ferizajt me mjete dhe paisje mbrojtëse mjekësore” dhe “Dezinsektimi, dezinfektimi i objekteve dhe haposirave publike për arsye të pandemisë Globale Covid-19”. INPO, nuk ka arritur t’i sigurojë PMK-të përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Kundër veprimeve të komunës, INPO ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

3.1.4. Mos-përmbushja e kontratës sipas afatit të planifikuar

INPO gjatë monitorimit të menaxhimit të kontratave ka analizuar nëse komunat kanë implementuar kontratat sipas afateve të parapara dhe ka gjetur se në rastin e Komunës së Vitisë për kontratën “Projekti ta pastrojmë Kosovën”⁷⁰ në PMK ka shënuar se punët duhet të fillojnë më 09.12.2019 dhe të përfundojnë më 03.06.2020, mirëpo kontrata ende nuk ka përfunduar. INPO konsideron se këtu kemi të bëjmë me keqmenaxhim i cili bie ndesh me përgjegjësitë dhe funksionet e menaxherit pasi në këtë rast “Menaxheri i Projektit do të duhej të sigurojë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, lidhur me funksionet e Menaxherit të Projektit që janë të sigurojë që OE i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës”. Komuna e Vitisë lidhur me këtë gjetje ka deklaruar se ky projekt është ndërprerë për shkak të mungesave buxhetore nga ana e MMPH-së si financuese e projektit dhe se OE është paguar vetëm aq sa ka punuar. Komuna në platformën e-prokurimi nuk ka ngarkuar asnjë dokument, njoftim apo marrëveshje lidhur me këtë ndërprerje të kontratës dhe as në komunikimet që i kemi zhvilluar për këtë kontratë gjatë fazës së monitorimit nuk na ka njoftuar që bëhet fjalë për shkëputje të kontratës. Sidoqoftë, këtu përsëri dëshmohet keqplanifikimi dhe keqmenaxhimi i cili përveç mos kryerjes së punëve krijon edhe mundësi që Komuna të paditet nga kompania për mospërmbushje të kontratës.

3.2. Mos-saktësimi i fillimit dhe mbarimit të kontratës

Në rastin e kontratave për punë AK-të duhet të saktësojnë datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës konform dispozitave ligjore të prokurimit publik dhe interpretimit të KRPP-së të datës 30.03.2017 nr. 133/2017 të KRPP-së, sipas të cilit “kërkohet që AK-të saktësisht të caktojnë datën e fillimit dhe mbarimit të implementimit të projektit-kontratës”.

Komuna e Kamenicës për tenderin “Asfaltimi i rrugëve lokale”⁷¹ në kontratën e nënshkruar nuk është saktësuar fare data e fillimit dhe përfundimit të punimeve. Afati kohor për përfundimin e punimeve, i cili është 120 ditë pas nënshkrimit të kontratës është shënuar në PMK. Njëjtë kanë vepruar edhe komunat: Deçan për

⁶⁹ Zyra Prokurimit nëpërmjet komunikimit elektronik deklarojnë se PMK i posedojnë menaxherat dhe se ata si zyre nuk i kanë.

⁷⁰ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷¹ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

kontratën “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes-Penda Vranoc”⁷² dhe për kontratën “Furnizim me E-kioskë”;⁷³ Glllogoc për kontratën “Renovimi dhe inventarizimi i Qendrës Rinore”⁷⁴ dhe për kontratën “Ndërtimi i Kapacitetit të Ujesjellsit në Drenas”;⁷⁵ Mitrovicë e Jugut për kontratën “Furnizimi dhe montimi i Serrave të tipit Tunell 50 m² komplet me montim (10X5)-50 copë”⁷⁶; dhe Leposaviç për kontratën “Shtrimi i rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Leposaviqit”.⁷⁷ Komunitatet në këto raste nuk kanë saktësuar datën e përfundimit të kontratës dhe kjo mund të krijojë fleksibilitet tek OE-të, për përfundim të punëve pasi komunitatet nuk po i obligojnë ata të përfundojnë në një datë të saktë. Për më tepër edhe mos definimi i ditëve të punës apo kalendarike sjellë diferenca të mëdha deri në përfundim të kontratës.

3.3. Siguria e Ekzekutimit të kontratave

Sipas RrOUPP-së, siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështesë përmbushjen e kontratës. Një siguri e ekzekutimit të kontratës mund të kërkojë, si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të sigurojë që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shpërbëhet kontrata.

Sipas nenit 30.6 të RrUOPP “Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”. INPO ka monitoruar nëse komunitatet kanë vepruar konform kërkesave ligjore në rastet kur kanë kërkuar sigurinë e ekzekutimit dhe ka gjetur se në disa raste komunitatet kanë përcaktuar kohëzgjatjen e sigurisë së ekzekutimit në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Komuna e Gjakovës ka nënshkruar kontratën “Furnizim me PC, laptop, TV smart dhe projektor”⁷⁸ më 04.12.2019. Kohëzgjatja e sigurisë së ekzekutimit është paraparë të jetë nga data 04.12.2019 deri më 04.02.2020 që në parim është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi kontrata ka kohëzgjatje prej një (1) muaji. Mirëpo, sipas PMK-së, kontrata do të përfundojë më 11.01.2020 duke rezultuar kështu që vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit të mbetet vetëm 24 ditë nga kompletimi i kontratës që i bie se pas datës 04.02.2020 nuk ka mbulueshmëri kjo siguri.

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka nënshkruar kontratën “Furnizimi dhe montimi i Serrave të tipit Tunell 50 m² komplet me montim (10X5) -50 copë”⁷⁹ më 04.05.2020. Sipas PMK afati për përmbushjen e kontratës është 60 ditë pune, ndërsa vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit për këtë kontratë është nga data 04.05.2020 deri më

⁷² PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷³ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁴ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁵ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁶ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁷ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁸ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁷⁹ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

02.08.2020. Rrjedhimisht, vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit mbetet më pak se 30 ditë nga data e kompletimit të kontratës.

Komuna e Pejës ka nënshkruar kontratën “Furnizim me lënd djegëse - dru për ngrohjen e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2019-2020”⁸⁰ më 19.06.2019. Bazuar në PMK afati i përmbushjes së kontratës është 19.06.2020, ndërsa vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit është deri më 17.07.2020 që i bie se është valide vetëm 28 ditë pas kompletimit të kontratës.

Komuna e Vitisë për kontratën “Projekti ta pastrojmë Kosovën”⁸¹ po ashtu ka përcaktuar kohëzgjatjen e sigurisë së ekzekutimit në kundërshtim me dispozitat ligjore. Respektivisht, siguria e ekzekutimit vadelitetin e ka deri më 03.06.2020 (ditën kur është dashur të përfundojë projekti).⁸²

Bazuar në gjetjet e mësipërme, në këto raste përveç që kemi të bëjmë me shkelje ligjore, gjithashtu i bie që në rast se OE dështojnë që t’i përfundojnë punët brenda afateve të parapara, komunat nuk kanë se si t’i penalizojnë kompanitë.

3.4. Shkelje të tjera

Në këtë pjesë INPO ka evidentuar disa raste që nuk janë shumë të shpeshta por që janë shumë të rëndësishme që të trajtohen.

Komuna e Prishtinës në tenderin “DDD i Institucioneve Arsimore”, nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së, sipas të cilit *“nëse një OE e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit”*. Ndërsa në rastin e kësaj kontrate, në ofertën e OE fitues çmimet kanë qenë jo-normalisht të ulëta dhe Komuna e Prishtinës nuk ka kërkuar shpjegime nga OE për këtë. Kjo vërtetohet edhe në vendimin e datës 04.02.2020 të Panelit Shqyrtues të emëruar nga OSHP. Se komuna ka qenë e paralajmëruar se mund të vije deri të një situatë e tillë për shkak të lëshimeve të bëra në Dosje të Tenderit e vërteton edhe fakti se OE-të e interesuar kishin parashtruar pyetje për sqarime lidhur me specifikimet në dosje, rreth asaj se si e planifikon komuna një dezinfektim të tillë duke mos-saktësuar mënyrën e dezinfektimit. OE-të kishin shprehur dyshimet e tyre dhe kishin ardhur në përfundim se mund “të fitojë” dikush me çmime jo-normalisht të ulëta. Megjithëse komuna kishte potencuar ndryshimet në Dosje për gabimet e lëshuara, nuk ka arritur të evitojë problemin dhe ka kontraktuar shërbime me çmime jo-normalisht të ulëta.⁸³

Në rastin e Komunës së Vitisë për kontratën “Projekti ta pastrojmë Kosovën”,⁸⁴ në bazë të dokumenteve dhe raporteve të organit mbikëqyrës dhe PMK-së, punimet “kanë filluar sipas parashikimeve” por pa një datë të saktë dhe deri më tani kemi

⁸⁰ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁸¹ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike

⁸² Shih nenin 63, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 30.6 të RROUPP-së

⁸³ Shih Pyetjen e OE-së, 12.12.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=791588

⁸⁴ PMK i siguruar përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, në formë elektronike.

fatura të OE-së në vlerë totale 74,793.62€. Është e çuditshme që për vetëm 13 ditë pune është paguar më shumë se 70% e tërë vlerës së projektit. INPO ka hulumtuar çmimet që OE fitues i ka ofruar dhe vërehet që për pozicione të njëjta ka dhënë çmime të ndryshme. Shembuj të tillë janë: Paramasa për Sodovinë të Çerkezëve pozicioni 2.2 është 85 euro për m², ndërsa Paramasa për Binqë pozicioni i njëjtë me numër 2.2 është 80 euro për m². Paramasa IV, pozicioni 1.5, 1.6, 1.9 ka çmime të ndryshme për pozicione të njëjta, krahasuar me paramasat e tjera. Në këtë rast përveç që Komuna e Vitisë ka paguar çmime të ndryshme për pozicione të njëjta, gjithashtu ka dështuar që ta ruajë paranë e taksapaguesve, gjë që është edhe obligim ligjor i paraparë me nenin 6 të LPP-së.⁸⁵ I pyetur për këtë gjë, respektivisht pse janë këto çmime të ndryshme për pozicione të njëjta, Menaxheri i prokurimit të Komunës së Vitisë më 24 Gusht 2020 nëpërmjet e-mailit ka deklaruar se “kjo është një pyetje sugjestive dhe se oferta është pranuar nga operatori ekonomik”.

⁸⁵ Shih nenin 6, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

IV. PROKURIMI ME POENTIM

Legjislacioni për prokurim publik iu mundëson AK-ve që kurdo që ato nuk i dinë sasi të indikative, të lidhin kontrata me çmime për njësi. AK-të duhet të përcaktojnë peshën në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” ose “grup të artikujve” në mënyrë që AK të përcaktojë se cila është oferta me çmimin më të ulët në bazë të poentimit, si për shembull për tenderët e mirëmbajtjes së veturave, mirëmbajtjes së gjeneratorëve, etj. Mirëpo, kontratat nuk mund të lidhen për ekzekutimin e punëve, si për shembull për punë ndërtimore, ndërtimi i objekteve, shtrim i rrugëve, apo në asnjë rast kur AK-të kanë mundësi t’i specifikojnë sasi të nevojshme për tenderim.

Kurdo që lidhet një kontratë me çmime për njësi, çmimet e deklaruara në tender dhe çmimet e mëtejshme në kontratat e dhëna janë çmime fikse dhe të obligueshme për palët e kontratës. Kontratat me kohëzgjatje prej më shumë se një viti mund të përshijnë klauzolë të veçantë në lidhje me rregullimin e çmimeve, megjithatë rregullime të tilla duhet të jenë të lidhura me indekse të një indeksi zyrtar të çmimeve të përcaktuar nga autoritete në Kosovë ose nga institucionet tjera ndërkombëtare të autorizuar. Indeksi i çmimit duhet të specifikohet në dosjen e tenderit. Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.⁸⁶

INPO ka monitoruar kontratat e dhëna gjatë vitit 2019 dhe 2020 me këtë kriter të dhënies, pra çmimi më i ulët me peshim/poentim në 20 komunat: Deçan, Dragash, Ferizaj, Gllogoc, Gjakovë, Gjiilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Rreth përdorimit të këtij kriteri në aktivitete të prokurimit, katër (4) komuna kanë deklaruar se nuk kanë zhvilluar tender me këtë kriter për këtë periudhë, dy (2) komuna nuk janë përgjigjur dhe 14 komuna kanë deklaruar se kanë zhvilluar, gjithsej 86 procedura me kriterin çmimi më i ulët me peshim/poentim. INPO ka monitoruar 22 procedura të prokurimit (shih shtojcën), ku katër (4) prej tyre janë për kategorinë punë, 17 për kategorinë shërbime dhe një (1) për kategorinë furnizim.

4.1. Dosja e Tenderit për tenderët me poentim

Fillimisht, INPO ka monitoruar Dosjen e Tenderit për këto kontrata dhe janë vërejtur mangësi të shumta pasi në shumë raste nuk është vendosur fare informata për poentim/peshim. Në bazë të RrOUPP, AK-të duhet të vendosin në Dosjen e Tenderit peshën (rëndësinë) e çmimeve të kategorive specifike dhe do të artikulojnë rëndësinë në përqindje dhe totali të jetë 100%. Nga 22 tenderët e monitoruar INPO ka gjetur se në 13 raste komunat nuk kanë vendosur në dosje të tenderit formulën/informatën për peshim të çmimeve.

⁸⁶ Shih nenin 28.14 të RrOUPP, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A01_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf

Ndërsa, në nëntë (9) raste komunat kanë dhënë informata lidhur me peshimin e çmimeve. Rastet e tilla janë: Komuna e Suharekës në tenderin “Mirëmbajtja edhe servisimi i automjeteve zyrtare”⁸⁷; Komuna e Klinës në dy tenderët “Mirëmbajtje dhe servisim i automjeteve zyrtare” dhe “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt në Territorin e Komunës së Klinës Lot 1 - zona parë e rrugëve, Lot 2 -zona dytë e rrugëve, Lot 3- zona e tretë e rrugëve”;⁸⁸ Komuna e Mitrovicës në tenderin “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale”;⁸⁹ Komuna e Vushtrrisë në dy tenderët “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale”;⁹⁰ dhe “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve”; Komuna e Kaçanikut në tenderin “Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve”;⁹¹ Komuna e Dragashit në tenderin “Servisimi i automjeteve- K.K. Dragash (24 muaj)”;⁹² dhe Komuna e Kamenicës në tenderin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale”⁹³). Ndërsa, në dokumentin “Përshkrimi/Lista e çmimeve” të gjitha komunat e monitoruara që kanë përdorur këtë kriter e kanë vendosur informatën rreth peshimit.

Gjithashtu, në secilën tender të monitoruar i është dhënë fokus vendosjes së kërkesave të cilat burojnë nga nenet 65-69 të LPP-së, mbi mundësitë teknike, ekonomike, financiare dhe kapacitetit profesional, ku është vërejtur se në disa raste komunat kanë vendosur kriteret të cilat kanë të bëjnë me kriterin e kufizimit fizik/territorial duke kufizuar distancën në kilometra të caktuara. INPO ka gjetur se Komuna e Vushtrrisë në tenderin “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve”⁹⁴, ka kufizuar distancën në 15 km nga objekti i komunës, Komuna e Suharekës në tenderin “Shërbimet e sigurimit të automjeteve zyrtare”⁹⁵ dhe Komuna e Gjakovës në tenderin “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për nevojat e Komunës së Gjakovës”⁹⁶, kanë kufizuar distancën në 10 km, si dhe Komuna e Prizrenit në tenderit “Servisimi i automjeteve të Komunës të Prizrenit dhe QKMF-së”.⁹⁷ ka kufizuar minimum 5 km dhe maksimum 15 km nga objekti i komunës.

Këto kufizime mund të rezultojnë në diskriminim të mundshëm mes OE-ve por edhe në kosto shtesë të buxhetit të AK-së. Një shembull i mire i përdorimit të një kufizimi të tillë i cili mund të eliminojë diskriminimin e mundshëm është rasti i Komunës së

⁸⁷ Shih Dosjen e Tenderit, 22.07.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=973743

⁸⁸ Shih Dosjen e Tenderit, 24.09.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=655199 dhe https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1010724

⁸⁹ Shih Dosjen e Tenderit, 30.04.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841076

⁹⁰ Shih Dosjen e Tenderit, 13.09.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=708903 dhe https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=557305

⁹¹ Shih Dosjen e Tenderit, 13.03.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=841997

⁹² Shih Dosjen e Tenderit, 09.09.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=675903

⁹³ Shih Dosjen e Tenderit, 11.11.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=719870

⁹⁴ Shih Dosjen e Tenderit, 31.05.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=557305

⁹⁵ Shih Dosjen e Tenderit, 14.02.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=788403

⁹⁶ Shih Dosjen e Tenderit, 23.06.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=928895

⁹⁷ Shih Dosjen e Tenderit, 22.07.2019, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=566837

Vitisë në tenderin “Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të autoritetit kontraktues dhe gjeneratorëve Lot 1 dhe Lot 2”⁹⁸, e cila e ka përdorur kufizimin e distancës në 10 km nga objekti i komunës, mirëpo për OE-të të cilat ndodhen më larg se 10 km duhet t’i bartin automjetet me shpenzimet e veta. (Për të parë numrin e ofertave për tenderët e monitoruar shih shtojcën pjesën e monitorimeve për poentim).

INPO, lidhur me këtë kufizim ka kërkuar sqarim edhe nga KRPP, ku nëpërmjet një e-maili më 11.01.2021, është pyetur se kur konsiderohet diskriminim një gjë e tillë sipas KRPP, dhe nga Departamenti i Rregullave pranë KRPP-së, më 18.01.2021 na janë përgjigjur se përveç që duhet të respektohen nenet 65-71 të LPP-së, AK-të në zbatim të nenit 7 të këtij ligji duhet të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjërë të mundshme të OE të interesuar, mirëpo në rastin konkret edhe nëse nuk e kufizon hapësirën territoriale brenda së cilës mund të ketë konkurrencë të mjaftueshme, mund të dëmtojë buxhetin e AK-së dhe mund të rezultojë me shkelje të parimit të ekonomicitetit dhe efikasitetit të përcaktuar me nenin 6 të LPP-së. Po ashtu, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji, në rastin konkret do të ishte më e arsyeshme të caktohet hapsira territoriale në mënyrë që autoriteti kontraktues të mund t’i shfrytëzojë në mënyrën më ekonomike fondet publike dhe burimet publike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, gjithnjë me kusht që të mos shkaktojë eliminim të konkurrencës ose të diskriminojë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë OE-ve.

4.1.1. KVK-të dhe kriteret diskriminuese lidhur me ISO Standarde në Dosje te Tenderit

Pjesë e rëndësishme apo thelbësore e kontratës pa dyshim që janë edhe KVK-të, mirëpo për disa komuna këto kushte po konsiderohen më pak të rëndësishme pasi nuk po plotësohen fare gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit. INPO ka gjetur se në pesë (5) tenderë Komunitat: Viti (2 tenderë), Dragash (1 tender), Prizren (1 tender), Klinë (1 tender), nuk i kanë plotësuar KVK-të, për kontratat me poentim (të vendosura në shtojcë). Plotësimi i tyre është obligim ligjor dhe në rast të kontesteve duhet të mbizotërojnë KVK-të.

Komunitat po vazhdojnë të vendosin kriteret diskriminuese gjatë publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, duke vendosur kriteret të përzgjedhjes ISO standarde të cilat nuk janë as valide. Komuna e Gjiçanit në Dosjen e Tenderit për projektin “Renimi i Objekteve” ka kërkuar pesë (5) lloje të ISO standardeve madje aty ka edhe standarde të shfuqizuara (shih pjesën e monitorimit të aktiviteteve të prokurimit - kriteret diskriminuese në Dosje te Tenderit). Gjithashtu, edhe Komuna e Podujevës ka kërkuar të njëjtin standard të shfuqizuar ISO 9001:2008 për Menaxhim të Cilësisë.

⁹⁸ Shih Dosjen e Tenderit, 21.08.2020, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1025717

4.2. Peshimi i çmimeve për kontratat për servisim të automjeteve

Gjatë periudhës 2019-2020 komunat me kriterin e dhënies çmimi më i lirë me peshim/poentim më së shumti kanë zhvilluar procedura të prokurimit për kategorinë shërbime, do të thotë kemi 11 komuna që kanë zhvilluar tender për “Servisim dhe mirëmbajtje e automjeteve zyrtare”. KRPP ka të publikuara disa lista të cilat përmbajnë çmimet referente për këto shërbime të cilat janë të ndara në disa kategori (A, B, C, D): Kategoria e parë (A) përfshin servisimin e rregullt; Kategoria e dytë (B) përfshin mirëmbajtjen dhe pjesët rezervë; Kategoria e tretë (C) përfshin riparimin dhe ngjyrosjen dhe Kategoria e katërt (D) përfshin pjesët e karroserisë. Edhe pse këto kategori përmbajnë çmime referente për automjete të ndryshme, prapë se prapë vështirësitë janë evidente pasi në treg kohë pas kohë ka lëvizje të çmimeve ndërkohë që lista e KRPP-së mbetet e pa përditësuar. Sidoqoftë, INPO ka monitoruar nëse komunat të paktën kanë respektuar kategorizimin e KRPP-së edhe pse një gjë e tillë nuk është decidivisht obligative. Si rezultat, INPO ka gjetur se janë disa komuna të cilat nuk e kanë përfillur plotësisht një gjë të tillë, si për shembull: Komuna e Klinës, Mitrovicë së Jugut, Prizrenit, Kaçanikut, Kamenicës. Këto komuna kanë zhvilluar procedurë të ngjashme vetëm se kategorizimi ka qenë ndryshe varësisht nga kërkesat e AK-së.

Komunat e tjera e kanë respektuar kategorizimin e KRPP-së, vetëm se kanë vendosur peshë për pozicione të ndryshme varësisht prej kërkesave të tyre. Ndërsa, komunat që kanë qenë identike në rëndësinë e peshës së pozicionit dhe në kategorizim janë: Dragashi, Gjakova, Vita dhe Vushtrria (shih tablën 5). Këto komuna rëndësi më të madhe i kanë dhënë servisimit të rregullt 60%, mirëmbajtjes dhe pjesëve rezervë 20%, riparimit dhe ngjyrojes 5% dhe pjesëve të karroserisë 15%.

Tabela 5. Çmimet e paguara për mirëmbajtje dhe servisim

Komuna →			Gjakovë	Dragash	Viti	Vushtrri
Nr.	Kategorizimi	Pesha në dosje	Çmimi i paguar nga AK	Çmimi i paguar nga AK	Çmimi i paguar nga AK	Çmimi i paguar nga AK
1.	Çmimi për servise të rregullta	60%	€ 3,690.00	€ 5,825.00	€ 807.00	€ 1,860.00
2.	Çmimi për mirëmbajtje dhe pjesë rezervë	20%	€ 157,287.00	€ 98,099.50	€ 27.70	€ 86,327.00
3.	Çmimi për riparime dhe Ngjyrosje	5%	€ 19,974.00	€ 11,836.00	€ 804.35	€ 5,814.00
4.	Çmimi për pjesët e karroserisë	15%	€ 45,898.00	€ 27,204.00	€ 4,619.40	€ 26,947.60
100%			18	30	28	32
Total Vetura →						

Burimi: Kontratat e nënshkruara

Komuna e Gjakovës, në tenderin “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për nevojat e Komunës së Gjakovës” në Lot 1- kishte përfshirë Servisimin dhe Mirëmbajtjen e Automjeteve të Komunës, ku kishte të përfshira gjithsej 18 vetura. Pavarësisht modelit të veturës, çmimi për servisim të rregullt deri në 10,000.00 km komunës i kishte kushtuar 165.00 Euro. Ndërsa, për mirëmbajtje dhe pjesët rezervë vaji i motorit për secilin automjet (18 modelet) është nga 15.00 euro.

INPO, ka hulumtuar tregun lidhur me çmimet e tregut të ofertës së Komunës së Gjakovës dhe janë nxjerrë çmimet si në vijim:

Tabela 7. Çmimet e ofertura dhe çmimi i tregut

Produkti	Çmimi në paramasën e OE fitues	Çmimi në treg
Vaji i Motorit	15.00 €	10.00€
Filteri i Vajit	15.00 €	10.00€
Filteri i Ajrit	20.00 €	7.00€ - 12.00€
Filteri i Benzinës/ Naftës	20.00 €	7.00€ - 12.00€
Filteri i Klimës	15.00 €	10.00€

Burimi: paramasat e komunës së Gjakovës dhe çmimet e tregut

Ndërsa, të Komuna e Dragashit në tenderin “Servisimi i automjeteve- K.K. Dragash (24 muaj)”, paramasa është e pa-lexueshme, pra nuk vërehen çmimet në dokumentin e skanuar. Për një gjë të tillë INPO ka kërkuar sqarime nga Komuna dhe atë kanë deklaruar se edhe paramasat që ata e posedojnë është e njëjtë me versionin e publikuar.

Ndërsa, komunat Viti,⁹⁹ Vushtrri,¹⁰⁰ dhe Gjakovë,¹⁰¹ kanë paguar çmime jo-reale dhe në shpërputhje me çmimet e tregut, përkatësisht për paramasa të njëjta komunat kanë paguar çmime të ndryshme, madje dy-tri herë më të larta. Për shembull Komunës së Vushtrrisë një (1) litër vaj i motorit për automjetin Toyota (viti prodhimit 2004 diesel) do t’i kushtojë pesë (5) euro, ndërsa për të njëjtën veturë një litër vaj të motorit Komunës së Vitisë do t’i kushtojë 12€ dhe Komunës së Gjakovës produkti i njëjtë do t’i kushtojë edhe më shtrejtë ku ajo do të paguajë 15€ për litrën e njëjtë.

4.3. Peshimi i çmimeve për kontratat për mirëmbajtje të rrugëve lokale

Në kontratat që zhvillohen me kriterin e dhënies çmimi më i lirë me poentim bëjnë pjesë edhe kontratat për mirëmbajtje të rrugëve lokale verore dhe dimërore dhe INPO ka vërejtur se nga komunat e fokusit, për këtë lloj tenderi/kontrate procedura kanë zhvilluar Komuna e Kamenicës dhe Komuna e Klinës.

Komuna e Kamenicës për tenderin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale” ka përdorur kategori të cilat i emërton si: Tabela I - kategori e cila vlerësohet me peshë 30% (në këtë kategori përfshihen 26 pozicione të cilat kryesisht kanë të

⁹⁹ Kontrata “Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të autoritetit kontraktues dhe gjeneratorëve Lot 1 dhe Lot 2”

¹⁰⁰ Kontrata “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve”

¹⁰¹ Kontrata “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për nevojat e Komunës së Gjakovës”

bëjnë me pastrim të borës deri në 7 km); Kategoria e dytë është e emërtuar si Tabela II e cila është e peshuar me 60% (në këtë kategori përfshihen 40 pozicione të cilat kanë të bëjnë me pastrim të rrugëve nga bora deri në 9 km nga fillimi i rrugës); dhe Kategoria e tretë është emërtuar Tabela III - me peshë 10% (në këtë kategori bëjnë pjesë 23 pozicione, duke përfshirë pastrim të përrojve, bartje të dheut/ mbeturina, largimi i lloqit, mbeturinat nga shiu, etj).

Komuna e Klinës për tenderin “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt në territorin e Komunës së Klinës: Lot 1- Zona e parë e rrugëve, Lot 2- Zona e dytë e rrugëve, Lot 3- Zona e tretë e rrugëve” e ka ndarë kontratën në tri (3) Lot-e dhe në të tri Lot-et komuna i ka dhënë rëndësi më të madhe “pastrimit të borës, shpërndarjes së kripës dhe rërës/orët efektive të borës- pastruesit/ kamionit në rrugë” e cila është vlerësuar me 50%, pastaj “furnizimit me kripë” me 30%, dhe kategoria e tretë “furnizimi me rërë” vlerësohet me 20%.

4.4. Kontratat - kategoria punë me kriterin për dhënie çmimi më i lirë më poentim

Një e gjetur tjetër interesante në komuna është edhe keqpërdorimi i kriterit për dhënie “çmimi më i lirë me peshim/poentim” i cili bazuar në dispozitat ligjore nuk mund të jepet për kontratat për punë ndërtimore. Në bazë të nenit 56.15 të RrUOPP “çmimi për njësi mund të përdoret vetëm kur nuk dihen sasitë indicative”, dhe këtë e argumenton edhe më shumë përgjigja në pyetjen 75 (“Pyetjet më të shpeshta” në e-prokurim - KRPP) e cila sqaron se “Kontratat Publike Kornizë me çmime për njësi lejohen për punë (riparim/ mirëmbajtje), por në asnjë mënyrë nuk lejohen për punë ndërtimore, shembull: ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i objekteve, etj.

Megjithatë, INPO gjatë monitorimit ka hasur në disa raste kur komunat kanë inciuar kontrata të cilat në Klasifikimin e Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP) e kanë kodin “punë ndërtimore”. Një shembull i tillë është Komuna e Vitisë e cila ka dhënë kontratë me kriterin çmimi më i ulët me poentim për tenderin “Rregullimi i Rrugëve Rurale në Komunën e Vitisë”, e gjithashtu njëjtë ka vepruar edhe Komuna e Gjilanit e cila ka përdorur kriterin çmimi më i lirë me poentim për kontratë të kategorisë punë me kodin punë ndërtimore (45000000-7) për tenderin “Punë Publike- projekte të vogla në infrastrukturë”. Pra, në këto dy (2) raste bëhet fjalë për ndërtim të rrugëve, ndërtim të objekteve dhe përdorimi i këtij kriteri është në kundërshtim me dispozitat ligjore, në këto dy (2) raste janë nënshkruar kontrata në vlerë 1,410,000.00 euro në kundërshtim me ligjin.

V. Rekomandime

INPO rekomadon që komunat të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive ngritjen e transparencës, mbi mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e të gjithë zyrtarëve të përfshirë në procedura të prokurimit publik, të cilët haptas veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, aplikimin e kriterëve kufizuese/diskriminuese dhe të tjera veprime që e cenojnë në çfarëdo forme integritetin e proceseve të prokurimit publik.

INPO, po ashtu rekomandon që administrimi i implementimit dhe menaxhimi i kontratave të jëtë më cilësor dhe më llogaridhënes. Menaxherët e kontratave të jenë më të përgjegjshëm dhe aktiv në kryerjen e detyrave dhe obligimeve për zbatim të suksesshëm të kontratave.

Rekomandime tjera po aq të rendësishme janë edhe këto ku:

- Komunat duhet të kujdesen që të mos shkurtojnë afatet për pranimin e tenderëve/ofertave pa pasur arsye të bazuara në dispozitat ligjore të Prokurimit Publik.
- Komunat duhet të kujdesen që të mos vendosin kriterë kufizuese/diskriminuese të cilat krijojnë pabarazi në mes të operatorëve ekonomik.
- Komunat validitetin e sigurisë së ekzekutimit ta kërkojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për Prokurim Publik.
- Komunat të përdorin drejt kriteret e dhënies së kontratave me çmimin më të lirë me peshim/poentim, si dhe të kujdesen që çmimet e kontraktuara të mos jenë më të larta se çmimet e tregut.
- Komunat procesin e vlerësimit të tenderëve ta përfundojnë brenda afatit të përcaktuar me dispozitat ligjore, pra brenda 30 ditëve.
- Komunat duhet të kujdesen që në rastet e kontratave për punë të saktësojnë datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës, dhe jo të përdorin praktikën e zakonshme ku vendosin kohëzgjatjen vetëm në ditë ose muaj.
- Komunat duhet të kujdesen që të hartojnë planin e menaxhimit të kontratës konform kërkesave ligjore, gjithashtu menaxheri i kontratës të mbahet përgjegjës për funksionin dhe përgjegjësitë e tij në përputhje me dispozitat ligjore.

Rreth INPO

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni i Organizatës INPO është për institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës, ndërsa INPO për mision ka promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizmit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur.

Vizioni dhe misioni i Organizatës INPO përmbushen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të Organizatës: (i) Programi për Qeverisje të Mirë, dhe (ii) Programi për Zhvillim Demokratik. Ky dokument është produkt i Programit për Qeverisje të Mirë, program i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të mirë dhe më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në institucionet publike.

Shtojcë. 81 Tenderët e monitoruar

#	Komuna	Titulli i projektit	Numri i ofertave	Numri i prokurimit
1	Dragash	“Servisimi i automjeteve- K.K. Dragash (24 muaj)”*	2	621-19-6577-2-2-1
2	Dragash	"Furnizimi me material hixhienik (2020-2022) - 24 muaj".*	3	621-20-574-1-2-1
3	Gjilan	“Rrërimi i Objekteve”.*	2	651-19-6389-5-2-1
4	Gjilan	“Punë Publike - projekte të vogla në infrastrukture”.*	3	651-20-584-5-1-1
5	Prizren	"Pastrimi dhe mirëmbajtja e autoveturave të Komunës së Prizrenit dhe QKMF-së".*	1	622-19-209-2-3-6
6	Prizren	"Servisimi i automjeteve të Komunës të Prizrenit dhe QKMF së".*	2	622-19-5353-2-2-1
7	Kamenicë	“Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve”.*	9	KM653-19-5503-2-2-1
8	Kamenicë	“Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale”.*	3	KM653-19-8763-2-2-1
9	Suharekë	"Mirëmbajtja edhe sevisimi i automjeteve zyrtare".*	1	624-20-3621-2-2-1
10	Gjakovë	"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për nevojat e Komunës së Gjakovës".*	3	632-20-3092-2-2-1
11	Klinë	“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me asfalt ne Territorin e Komunës se Klinës LOT 1 - ZONA PARË E RRUGËVE. LOT 2 -ZONA DYTË E RRUGËVE, LOT 3- ZONA E TRETË E RRUGËVE”.*	5	634-19-7193-2-2-1
12	Klinë	“Mirëmbajtje dhe servisim i automjeteve zyrtare”.*	2	634-20-4287-2-2-1
13	Mitrovicë e Jugut	“Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve te Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale”.*	2	642-20-920-2-1-1
14	Kaçanik	"Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (poentim)".*	1	652-20-827-2-2-1
15	Viti	"Rregullimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë".*	7	657-20-2096-5-1-1
16	Podujevë	“Riparimi i rrugëve të asfaltuara”.*	10	615-20-2884-5-2-1

17	Viti	"Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të autoritetit kontraktues dhe gjeneratorëve Lot 1 dhe Lot 2".*	1	657-20-4626-2-2-1
18	Prishtinë	"Hapja e puseve për ujitje në oborret e shkollave".*	2	616-20-2237-5-2-1
19	Prishtinë	"Shërbime të veçanta kontraktuale për përfaqesin ligjor për nëvojat e Komunës së Prishtinës".*	1	616-20-1722-2-2-5
20	Glllogoc	"Mirëmbajtja dhe Servisimi i veturave për Institucionet e Komunës së Drenasit".*	2	611-20-102-2-2-1
21	Vushtrri	"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale".*	1	VU644-19-6955-2-2-1
22	Vushtrri	"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve".*	1	VU644-19-3677-2-2-1
23	Gjakovë	"Dezinfektimi emergjent i gjitha objekteve dhe hapësirave publike".**	1	632-20-998-2-2-5
24	Klinë	"Furnizim me medikamente për parandalim të pandemisë COVID-19".**	3	634-20-1055-1-2-5
25	Mitrovicë e Jugut	"Dezinfektimi i hapësirave të Objekteve Institucionale dhe Objekte Kolektive për shkak të Pandemisë COVID-19"***	2	642-20-1661-2-2-5
26	Gjilan	"Furnizime me maska dhe material dezinfektues".**	1	651-20-1477-1-3-5
27	Dragash	"Dezinfektimi i institucioneve publike (shkollat, institucionet shëndetësore, bibliotekat, zyrët e vendit, objekti i Komunës...) në teritorin e komunës së Dragashit (procedura negocuar)".**	3	621-20-1866-2-3-5
28	Podujevë	"Dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike".**	1	615-20-932-2-2-5
29	Prishtinë	"Furnizimi me materiale mbrojtëse personale - emergjente".**	1	616-20-858-1-2-5
30	Dragash	"Furnizimi me material mbrojtës shëndetësor".**	3	621-20-1242-1-2-5
31	Prizren	"Dezinfektimi i objekteve Komunale dhe i hapësirave publike në Komunën e Prizrenit".**	1	622-20-1003-2-2-5

32	Prizren	"Furnizim me material shpenëzues sanitar për nevojat e shërbimeve shëndetësore për mbrojtje nga Korona virusi në Komunën e Prizrenit". **	1	622-20-1095-1-2-5
33	Kamenicë	"Shërbimet e dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Kamenicës". **	2	KM653-20-1137-2-3-5
34	Ferizaj	"Dezinsektimi, dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike për arsye të pandemis globale Covid 19". **	1	656-20-1487-2-2-5
35	Ferizaj	"Furnizimi i QKMF-së dhe Spitalit me mjete dhe pajisje mbrojtëse mjekësore". **	1	656-20-1616-1-2-5
36	Viti	"Dezinfektimi i objekteve shkollë, komunale dhe hapësirat publike". **	3	657-20-913-2-2-5
37	Shtime	"Dezinfektimi për hapësirat e objekteve, institucioneve shkollë, kulturore, komunale dhe shëndetësore (faza e dytë)". **	2	617-20-1563-2-2-5
38	Kaçanik	"Furnizimi me material medicinal". **	2	652-20-1311-1-2-5
39	Kaçanik	"Shërbimet e dezinfektimit të hapësirave publike". **	1	652-20-1779-2-3-5
40	Deçan	"Furnizim me e - kioske"	1	631-19-5026-1-2-1
41	Deçan	"Ndërtimi i kanaleve të ujitjes-Penda Vranoc"	6	631-19-4825-5-2-1
42	Deçan	"Furnizim me Material Laboratorik"	3	631-20-600-1-2-1
43	Deçan	"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit"	6	631-20-1999-2-1-1
44	Gjakovë	"Furnizim me PC, laptop, TV smart dhe projektor"	3	632-19-6781-1-2-1
45	Gjakovë	"Ndërtimi dhe sanimi i urave"	8	632-20-1174-5-2-1
46	Gjakovë	"Nërtimi i ashensorit në QKMF"	2	632-20-4292-5-2-1
47	Klinë	"Ndërtimi i rrugëve lokale dhe infrastrukturës nëntokësore në Sferk"	3	634-20-4857-5-2-1
48	Mitrovicë e Jugut	"Furnizimi dhe montimi i Serrave të tipit Tunell 50m2 komplet me montim (10X5) -50 copë"	2	642-20-144-1-2-1

49	Mitrovicë e Jugut	"Rregullimi i nyjeve sanitare (Gjimnaz)"	3	642-19-6154-5-2-1
50	Pejë	"Furnizim me lënd djegëse - dru për ngrohjen e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2019/2020"	2	635-19-1434-1-1-1
51	Pejë	"Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën Bill Clinton në Pejë"	7	635-19-986-5-2-1
52	Pejë	"Ndërtimi i shkollës së Artit Faza Finale"	14	635-20-2467-5-2-1
53	Pejë	"Furnizimi me artikuj elektrik për nevojat e drejtorateve të SHCK-së"	10	635-20-1551-1-2-1
54	Prishtinë	"DDD i institucioneve arsimore"	3	616-19-9412-2-2-5
55	Podujevë	"Ndërtimi i disa tereneve sportive"	10	615-20-3712-5-2-1
56	Podujevë	"Ndërtimi i shkollës Ali Ajeti në fshatin Balloç"	14	615-20-1856-5-1-1
57	Glllogoc	"Ndërtimi i Kapacitetit të Ujësjetës në Drenas"	2	611-19-8366-5-2-1
58	Glllogoc	"Renovimi dhe inventarizimi i qendres rinore"	6	611-19-8413-5-2-1
59	Glllogoc	"Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Drenasit"	3	611-20-2707-5-2-1
60	Vushtrri	"Furnizim me material higjienik për AK-Vushtrri"	6	VU644-19-1091-1-2-1
61	Vushtrri	"Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet"	12	VU644-19-1843-5-1-1
62	Leposaviq	"Rregullimi i ngushtë të qendrës së ngushtë të fshatit Leposaviq"	1	641-19-4786-5-2-1
63	Leposaviq	"Shtrimi i rrugëve dhe rrugëve në territorin e komunës së Leposaviqit"	1	641-19-3020-5-2-1
64	Leposaviq	"Prokurimi i celularve"	2	641-20-4870-1-3-6
65	Leposaviq	"Prokurimi i paisjeve për shuraje e zjarrit"	1	641-20-5277-1-3-6
66	Ferizaj	"Vazhdimi i nënkalimit për këmbësor dalja në rrugën Emin Duraku- projekt dy vjeçar"	2	656-20-2163-5-1-1
67	Ferizaj	"Shërbime profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit"	1	656-20-2019-2-1-5
68	Viti	"Projekti ta pastrojmë Kosovën"	4	657-19-8317-5-2-1
69	Shtime	"Rregullimi i hapësirave rekreative sportive tek qendra rinore"	5	617-19-6755-5-2-1

70	Shtime	"Transporti i pacienteve për hemodializë Ri - tenderim"	1	617-20-1243-2-2-1
71	Shtime	"Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc"	10	617-19-4374-5-2-1
72	Kaçanik	"Furnizimi dhe montimi i serrave për fermer"	2	652-20-1594-1-2-1
73	Mitrovicë e Veriut	"Rindërtimi i infrastrukturës rrugore të pjesës së rrugës Kralja Petra 1 në Mitrovicën Veriore"	1	647-20-3001-5-1-1
74	Mitrovicë e Veriut	"Prokurimi i pajisjeve IT për nevojat e Komunës së Mitrovicës së Veriut"	4	647-20-1715-1-2-1
75	Gjilan	"Furnizim me automjete shëndetsore"	1	651-19-4153-1-2-1
76	Kamenicë	"Asfaltimi I rrugëve Lokale"	5	KM653-3503-5-2-1
77	Suharekë	"Shërbimet e sigurimit të automjeteve zyrtare"	3	624-20-405-2-2-1
78	Suharekë	"Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)- Lagjja Zekolli, Suharekë"	9	624-19-6384-5-1-1
79	Suharekë	"Asfaltimi i rrugës Bukosh Reqan". ***	1	624-18-5080-5-2-1
80	Mitrovicë e Veriut	"Shërbimet e sigurisë fizike të ndërtesës së komunës së Mitrovicës së Veriut". ***	2	647-19-5150-2-2-1
81	Mitrovicë e Veriut	"Mbrojtja dhe restaurimi i fasadës së oborrit në rrugën Petra 1 me rregullimin e parterit dhe renovimi i kulmit të objektit të banimit në rrugën Knjaz Milos nr.32 në Mitrovicën e Veriut". ***	1	647-19-5322-5-2-1

Burimi: Platforma e-prokurimi

* Me kriterin e dhënies çmimi më i lirë me peshim/poentim

** Me procedurë të negociuar pa Publikim të Njoftimit të Kontratës/COVID-19

*** Nuk janë pranuar dokumentet. INPO është ankuar pranë Avokatit të Popullit